

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE “UEJL”**

**FAKULTETI JURIDIK**

**STUDIME POSTDIPLOMIKE – MASTER**

**DREJTIMI CIVIL**



**PUNIM DIPLOME**

**ADOPTIMI NDËRKOMBËTAR I FËMIJËVE – ASPEKTET**

**KRAHASUESE**

Kandidati:

Labinot Ziberi

Mentori:

Prof. Dr. Bekim Nuhija

Shkup, Maj 2019

## Abstrakt

Punimi “Adoptimi ndërkombëtare i fëmijëve - aspektet krahasuese” ka si objekt kryesor studimi adoptimin e fëmijëve të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë në rrafshin ndërkombëtar, si dhe aspektet krahasuese ndërmjet këtyre shteteve. Adoptimi ndërkombëtar i fëmijëve të Kosovës e po ashtu edhe të shteteve të rajonit, bëhet vetëm në rastet kur fëmijët të cilët janë në regjistrat për adoptim, nuk arrijnë të adoptohen në shtetin amë. Edhe pse legjislacioni vendor dhe ai ndërkombëtar parasheh mbrojtjen e fëmijëve dhe detyron prindërit për kujdes familjar ndaj fëmijëve të tyre, janë jo të pakta rastet e braktisjes së fëmijëve të cilët më pas bëhen pjesë e kujdesit institucional, si dhe të adoptimit vendor apo ndërkombëtar. Pa hyrë në detaje mbi arsyet e braktisjes së fëmijëve, në vijim të këtij studimi do të analizohet në detaje një nga mënyrat e mbrojtjes së fëmijëve, e që është adoptimi (birësimi), ku i adoptuari dhe adoptuesi duhet të krijojnë marrëdhënie prind-fëmijë, njëjtë sikurse është marrëdhënia prind-fëmijë biologjik.

Punimi i kësaj teme lidhet ngushtë me krahasimin e legjislacionit (procedurave dhe akteve në fuqi) të adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë, progresin historik (të metat dhe të arriturat), si dhe procedurat mbi adoptimin e fëmijëve. Qëllimi i këtij hulumtimi është kryerja e një analize të thukët të çështjes së adoptimit të fëmijëve në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar, pasi braktisja e fëmijëve dhe njëkohësisht adoptimi i disa prej tyre është mjaft i përhapur, por nuk është trajtuar mjaftueshëm as në nivelin vendor e as në atë ndërkombëtar. Po ashtu, në këtë punim, janë dhënë edhe disa rekomandime mbi adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve të Kosovës, gjithnjë për mbrojtje të interesit më të lartë të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe fëmijëve të braktisur.

**Fjalët kyçe:** *adoptim, fëmijë, prind, adoptues, kujdesi.*

## Përmbajtja

## Përmbajtja

Abstrakt.....	2
Hyrje .....	5
KAPITULLI I .....	7
1.Kuptimi i adoptimit, rëndësia dhe burimet .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1.1. Kuptimi i adoptimit dhe zhvillimi historik.....	13
1.2. Rëndësia e adoptimit në shoqëri.....	14
1.3. Burimet ndërkombëtare dhe nacionale mbi adoptimin .....	14
1.4. Kushtetuta si burim i së drejtës familjare.....	13
1.5. Ligji si burim i së drejtës familjare .....	164
1.6. Marrëveshjet ndërkombëtare si burim i së drejtës familjare .....	164
1.7. Praktika gjyqësore si burim i së drejtës familjare .....	175
1.8. Tradita si burim i së drejtës familjare.....	186
1.9. Shkenca juridike si burim i së drejtës familjare .....	216
1.10. Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	227
1.11. Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në marrëdhëniet bashkëshortore dhe familjare .....	<b>Error! Bookmark not defined.8</b>
KAPITULLI II .....	21
2. Rregullimi juridik i marrëdhënieve familjare.....	71
2.1. E drejta që të dihet prejardhja e fëmijës .....	7
2.2. Domethënia dhe llojet e adoptimit .....	8
2.3. Kushtet e adoptimit .....	9
2.4. Kushtet për plotfuqishmërinë e adoptimit.....	9
2.5. I adoptuari .....	9
2.6. Adoptuesi .....	9

2.7.	Kusht i përbashkët për të adoptuarin dhe adoptuesin.....	9
2.8.	Pëlqimi i prindërve të fëmijës i cili adoptohet dhe i të adoptuarit .....	9
2.9.	Procedura e adoptimit.....	30
KAPITULI III .....		33
3.	Aspektet krahasuese në mes shteteve të rajonit për adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve ...	33
3.1.	Realizimi i adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve të Maqedonisë , Kosovës dhe Shqipërisë.....	35
3.1.1.	Procedura e adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve të Republikës së Kosovës .....	36
3.1.2.	Procedura e adoptimit ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë.....	39
3.1.3.	Procedura e adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve të Republikës së Maqedonisë ...	40
3.1.4.	Dokumentet që duhet plotësuar për adoptim ndërkombëtar të fëmijëve .....	41
3.1.5.	Mendimi dhe pëlqimi i fëmijës që adoptohet si dhe mosha e adoptuesit dhe të adoptuarit.....	45
3.1.6.	Periudha provuese, paraadoptuese .....	48
3.1.7.	Themelimi i adoptimit, mbiemri dhe periudha pas-adoptuese.....	49
3.1.8.	E drejta në martesë dhe trashëgimi e të adoptuarit .....	53
3.1.9.	Ndalimet për adoptim .....	54
3.1.10.	Njohja e të adoptuarit me prindërit biologjikë dhe ruajtja e konfidencialitetit.....	55
KAPITULLI IV .....		58
4.	Efektet juridike dhe shuarja e adoptimit.....	58
4.1.	Efektet juridike të adoptimit.....	58
4.2.	Shuarja e adoptimit.....	60
4.3.	Statistika mbi adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve .....	62
Përfundime .....		66
Rekomandime .....		68
Bibliografia .....		69
Deklaratë e studentit .....		72

## Hyrje

Objekt studimi i këtij punimi është adoptimi i fëmijëve në nivel ndërkombëtar, si dhe aspektet krahasuese të adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve në mes Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë. Në të kaluarën adoptimi i fëmijëve më tepër ka qenë interes i adoptuesve për shkaqe trashëgimie apo arsye të tjera, kurse “interesi më i lartë i familjes” nuk ka qenë primar. Në Romën e Lashtë p.sh. qytetarët romakë të cilët nuk kishin fëmijë, përvetësonin fëmijë nga të afërmit e tyre ose nga shtresat e varfra, kryesisht për shkak të vazhdimit të familjes dhe kultit familjar. Kështu që adoptimi në këtë kohë ka qenë shumë i paqartë dhe i komplikuar. Më vonë në të drejtën klasike dhe post-klasike adoptimi u rregullua më për së afërmi, kështu adoptuesi duhet të ishte së paku 18 vjet më i vjetër se i adoptuari dhe duhej të bëhej më reskript të perandorit ose me procesverbal nga organi kompetent shtetëror.<sup>1</sup>

Me kalimin e kohës, adoptimi ka marrë përmasa të tjera dhe ligjvënësit gjithnjë e më tepër kujdes primar gjatë adoptimit i kanë kushtuar mirëpritjes së fëmijës, pra interesit më të lartë të fëmijës. Me krijimin e institucioneve për përkujdesje ndaj fëmijëve të braktisur, rrjedhimisht, me adoptimin e disa prej tyre, mund të themi se tërthorazi luftohet: rrëmbimi i fëmijëve, trafikimi me fëmijë, eksploatimi seksual i tyre, detyrimi për kryerjen e çfarëdo pune tjetër që paraqet rrezik për jetën dhe shëndetin e fëmijëve. Sipas legjislacionit vendor të Kosovës “adoptimi i fëmijës është i lejuar nëse i shërben marrëdhënia prind-fëmijë”, (neni 163 par.1 i Ligjit për Familjen i Kosovës - në vijim LKF).<sup>2</sup>

Qëllimi i punimit - objekt hulumtimi i këtij punimi është adoptimi ndërkombëtar i fëmijëve, si një ndër format e mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror. Në punim është analizuar legjislacioni vendor dhe rajonal, por edhe ai ndërkombëtar, duke përfshirë këtu edhe Konventat mbi adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve.

Vlen të ceket se Konventa mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimet jashtë vendit, parasheh që gjatë adoptimit të merren masat mbrojtëse që adoptimet jashtë vendit të

---

<sup>1</sup> Asllan Bilalli, Bedri Bahtiri, E drejta Romake, Prishtinë, 2015, fq.194-195

<sup>2</sup> Ligji për familjen i Kosovës, Nr.2004/32, gazeta zyrtare e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, Prishtinë, 1.9.2006

realizohen, gjithnjë duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës dhe duke respektuar të drejtat e tij themelore të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare.<sup>3</sup>

Në punim janë analizuar dhe njëkohësisht është paraqitur procesi dhe të dhëna mbi:

- Adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve pa prindër dhe pa kujdes prindëror të: Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë;
- Rëndësinë e institucionit të adoptimit, si formë juridike familjare për mbrojtjen e fëmijëve pa prindër apo pa përkujdesje prindërore;
- Efektet juridike të adoptimit;
- Statistikat mbi adoptimet ndërkombëtare të fëmijëve etj.

Gjithashtu janë dhënë rekomandime lidhur me vetëdijesimin e shoqërisë mbi adoptimin, përmirësimin e procedurave mbi adoptimin, amendamentimin e legjislacionit të Kosovës për adoptim ndërkombëtar të fëmijëve, me qëllim të përmirësimit të procesit të adoptimit të fëmijëve pa prindër apo pa përkujdesje prindërore dhe institucionale, etj.

---

<sup>3</sup> Konventa mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimet jashtë vendit (Convention of 29 May 1993 on Protection of Children and Co-operation in Respect of Intercountry Adoption), Hage 29 maj 1993, Neni 1, a) f.1.

# KAPITULLI I

## 1. Kuptimi i adoptimit, rëndësia dhe burimet

### 1.1. Kuptimi i adoptimit dhe zhvillimi historik

Adoptimi (birësimi) është akt juridik solemn, me anë të së cilit personi madhor (adoptues) merr përsipër vullnetarisht, sipas ligjeve në fuqi, të rritë si të ishte fëmijë i tij, një ose më shumë të mitur. Fjala “adoptim” rrjedh nga latinishtja “Ad-optio” që do të thotë “me zgjedhë”.<sup>4</sup>

Nisur nga e drejta romake, sipas vullnetit të pater familiasit, në kuadër të familjes së tij mund të hynin edhe disa persona edhe pas momentit të lindjes. Hyrja në rrethin e familjes apo nën patria potestas të ndonjë personi në ndonjë moment pas lindjes quhej “adoptim”. Adoptimi duhet të bëhej patjetër me forma të parashikuara juridikisht. Përveç formave të tjera, adoptimi ndahej edhe në: Adoptio plena - sipas së cilës personi i adoptuar ndërpriste çdo lloj lidhje me familjen e mëparshme, dhe Adoptio minu plena - adoptuesi fitonte të gjitha të drejtat në familjen e adoptuesit, mirëpo nuk humbte të drejtat themelore me familjen e atit natyror (pra me familjen e tij biologjike).<sup>5</sup>

Sipas të drejtës romake, bëhesh pjesë e familjes:

- Aut natura me vërtetimin e faktit juridik të lindjes, dhe
- Aut iure në bazë të një akti juridik, siç është birësimi (adoptimi).<sup>6</sup>

Birësimi (adoptimi) ka gjetur rregullim juridik që në ligjet e Hamurabit (2283-2241 para erës sonë) dhe mori një zhvillim më të gjerë në të drejtën romake, megjithëse atëherë kishte një natyrë tjetër, sepse synonte në shtimin numerik të familjes romake.<sup>7</sup>

Vendet si Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia njohin institucionin e adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve, dhe ky proces kryhet sipas legjislacionit në fuqi. Disa vende të botës nuk njohën asnjëherë adoptimin (birësimin) si institut juridik dhe shoqëror. Madje adoptimi ka qenë i

---

<sup>4</sup> Ksanthipi Begeja, E Drejta Familjare e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1984, f.185-186

<sup>5</sup> Ivo Puhan, E drejta romake, Prishtinë, 1980, f.192-193

<sup>6</sup> Arta Mandro-Balili, Vjollca Mecaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, E Drejta Familjare, Tiranë, 2006, f.639

<sup>7</sup> Ibid

ndaluar edhe me norma ligjore.<sup>8</sup> Kështu nga 195 shtete të botës, adoptimi lejohet në 173 prej tyre.<sup>9</sup>

## **1.2. Rëndësia e adoptimit në shoqëri**

Meqë shumë çifte nuk mund të kenë fëmijë të tyre biologjikë, si dhe shumë çifte të cilët kanë fëmijë të tyre biologjikë, dëshirojnë të adoptojnë fëmijë të cilët janë pa përkujdesje prindërore, atëherë, siç e kemi cekur edhe më lartë, ekziston institucioni i adoptimit që, i cili u mundëson këtë çifteve apo personave të tjerë që plotësojnë kushtet të adoptojnë fëmijë, gjithmonë duke pasur parasysh interesin e fëmijës, që ai të ndjejë veten e tij në mjedis familjar si moshatarët e tij, apo nëse do të adoptohet nga familje e cila ka fëmijë biologjikë, atëherë të jetë i barabartë me fëmijët e adoptuesve, në çdo aspekt: jetesë, rritje, edukim, etj.

Në shekullin e kaluar, ndryshe nga koha e lashtë, qëllimi parësor i adoptimit bëhet mbrojtja e interesave të fëmijëve të mitur në legjislacionet e shumë vendeve të botës, pra ndryshon edhe qëllimi i adoptimit. Arsyet kryesore qëndrojnë në faktin se, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, një numër i madh i fëmijëve të mitur mbetën bonjakë pa përkujdesjen e domosdoshme prindërore. Vatra më e ngrohtë për çdo fëmijë është familja. Andaj vendosja në familje e këtyre fëmijëve, si institucion i pazëvendësueshëm për mirëpritjen dhe edukimin e brezit të ri, merr rëndësi edhe për shoqërinë edhe për shtetin. Duke i adoptuar këta fëmijë pakoheshin shpenzimet e shtetit lidhur me sigurimin e përkujdesjes dhe të mirëqenies materiale të fëmijëve të mitur pa përkujdesje prindërore.

Pra, është shteti ai që fillimisht, pas çdo braktisjeje përkujdeset që këta fëmijë të kenë strehim të posaçëm, ku një ndër format e mbrojtjes së fëmijës është adoptimi i tyre, qoftë vendor apo ndërkombëtar. Ligjvënësi ka parashikuar që për realizimin e të drejtave nga marrëdhëniet familjare, nënës dhe fëmijës u sigurohet mbrojtje e posaçme me mjete të mirëqenies sociale. Fëmijëve pa kujdes prindëror u sigurohet mbrojtja e posaçme përmes formave të mbrojtjes siç janë kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial dhe adoptimi”, (neni 7 par.1&2 i LFK). Në Kosovë, ndër arsyet që nënat e reja braktisin fëmijët që nga lindja, janë kushtet e rënda

---

<sup>8</sup> Hamdi Podgorica, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2011, f.203

<sup>9</sup> Adoptimi i fëmijëve, trendët dhe politikat (Child Adoption, Trends and Policies) New York, 2009, f.26&65.



sociale dhe mospranimi i fëmijës nga babai, pasi që lidhjet e tyre në të shumtën e rasteve janë jashtëmartesore. Braktisja e foshnjave është edhe si rezultat i mungesës së informimit për shëndetin riprodhues, për planifikimin familjar etj.,<sup>10</sup> kështu rastet më të shpeshta të braktisjes së foshnjave janë nga nënat e moshave rreth 18-22 vjeç.<sup>11</sup>

Kjo është një dukuri shqetësuese, edhe pse në shtete të ndryshme, braktisja e fëmijëve, apo mbetja e fëmijëve pa përkujdes prindërore vjen si rezultat i kushteve të ndryshme jetësore, p.sh. në vendet afrikane shqetësuese është edhe adoptimi ndërkombëtar i fëmijëve si pasojë e krizës/sëmundjes së AIDS-it e cila ka shkatërruar aq shumë popullsinë e rritur në shumë vende afrikane, sa që mijëra e mijëra “jetimë të AIDS-it”, disa HIV-pozitive dhe të tjerë jo, janë lënë pa ndonjë kujdes familjar. Kështu vendet e varfra të Amerikës Latine kanë dërguar disa prej fëmijëve të tyre për adoptim ndërkombëtar, përderisa Afrika ka dërguar shumë pak fëmijë për adoptim të tillë (Greene 2002).<sup>12</sup>

Braktisja e fëmijëve sjell deri te rritja e rasteve për përkujdesje të tyre nga institucionet, e po ashtu deri te adoptimi i tyre, qoftë vendor apo ndërkombëtar. Në vijim janë të paraqitura burimet ndërkombëtare dhe vendore të adoptimit të fëmijëve.

### **1.3. Burimet ndërkombëtare dhe nacionale mbi adoptimin**

Pavarësisht se çështja e adoptimit njihet që nga lashtësia, legjislacioni për adoptim, e posaçërisht për adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve, në përgjithësi, kohëve të fundit është i shprehur më shumë se kurrë më parë. Si legjislacioni vendor, po ashtu edhe ai ndërkombëtar sa i përket adoptimit të fëmijëve, si kusht të domosdoshëm ka paraparë interesin më të lartë të fëmijës së adoptuar. Shtetet të cilat njohin adoptimin, përfshirë Kosovën, adoptimin si vendor apo ashtu edhe atë ndërkombëtar e kanë rregulluar sipas legjislacionit në fuqi dhe kjo bëhet vetëm sipas kushteve dhe procedurave të paraqitura me legjislacionin në fuqi të shtetit përkatës.

---

<sup>10</sup> <http://botasot.info/kosova/910967/sdo-muaj-nga-nje-foshnje-e-braktisur/> (marrë më datë 01 prill 2019)

<sup>11</sup> Intervistë 2018 me zyrtarë të Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare (DPSF), Ministria e punës dhe politikës sociale, datë 16.04.2019.

<sup>12</sup> Lori Askeland, Adoptimi ndërkombëtar, kapitulli “Fëmijët dhe të rinjtë në adoptim, jetimoret dhe kujdesi për strehim”, Greenwood Publishing Group Inc., 2005 f.110 i disponueshëm në [www.law.harvard.edu/faculty/bartholet/pdfs/IAChapter5FINAL.pdf](http://www.law.harvard.edu/faculty/bartholet/pdfs/IAChapter5FINAL.pdf) (marrë më 16 prill 2019).

Në vijim do të paraqesim disa nga burimet ndërkombëtare dhe vendore mbi adoptimin e fëmijëve.

Burimet ndërkombëtare të adoptimit - në nivel ndërkombëtar deri vonë nuk ka janë paraparë dispozita konkrete sa i përket adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve. “Ligji i Masacusetit për adoptimin e fëmijëve” (1851) konsiderohet të jetë ligji i parë modern mbi adoptimin në Amerikë, duke u përcjellë më pas me akte të ndryshme mbi adoptimin.<sup>13</sup> Në vitin 1948 është nxjerrë “Deklarata e përgjithshme për të drejtat e njeriut”, në të cilën parashihet se “Nëna dhe fëmija kanë të drejtë për ndihmë dhe asistencë të posaçme. Të gjithë fëmijët, qofshin të lindur në martesë apo jashtë saj, gëzojnë mbrojtje shoqërore të njëjtë”.<sup>14</sup> Pastaj është nxjerrë, “Deklarata për parimet sociale dhe ligjore, lidhur me mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve, me referencë të posaçme të vendosjes nën kujdes dhe adoptim vendor dhe ndërkombëtar”,<sup>15</sup> e cila përveç tjerash po ashtu parasheh se “në të gjitha procedurat e vendimmarrjes dhe adoptimit, interesi më i lartë i fëmijës duhet të merret në konsideratë”.

“Konventa mbi të drejtat e fëmijës”<sup>16</sup>, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në nenin e 20 shtjellon çështjen e mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje prindërore, apo të fëmijëve të cilëve në mënyrë të përkohshme ose të përhershme u mohohet mjedisi familjar, apo kur nuk është në interesin e fëmijës të qëndrojë në një mjedis pa përkujdesje, atëherë ata kanë të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm. Shtetet që pranojnë birësimin garantojnë që interesi më i mirë i fëmijës të jetë në qendër të vëmendjes. Rëndësi të veçantë në këtë aspekt ka edhe “Konventa mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimet jashtë vendit” (në vijim Konventa e Hagës”),<sup>17</sup> e cila më në detaje parasheh dispozita mbi adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve.

Burimet nacionale të adoptimit (Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni) - Edhe pse Republika e Kosovës nuk është nënshkruese e Konventave për adoptim ndërkombëtar të fëmijëve, megjithatë

---

<sup>13</sup> Artikulli, “Histori e shkurtër mbi adoptimin”, i disponueshëm në: [www.pages.uregon.edu/adoption/timeline.html](http://www.pages.uregon.edu/adoption/timeline.html) (marrë më 16 prill 2019).

<sup>14</sup> Zejnullah Gruda, Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut (dokumente dhe materiale), Prishtinë, 2010, f.27

<sup>15</sup> Deklarata për parimet sociale dhe ligjore, lidhur me mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve me referencë të posaçme të vendosjes nën kujdes dhe adoptim vendor dhe ndërkombëtar”.

<sup>16</sup> Konventa mbi të drejtat e fëmijëve (Convention on the Rights of the Child), 20.11.1989, e disponueshme në: [www.ohchr.org/en/proffesionalinterest/pages/crs.aspx](http://www.ohchr.org/en/proffesionalinterest/pages/crs.aspx)

<sup>17</sup> Konventa mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimet jashtë vendit, Supra note 3.

në nenin 22 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës<sup>18</sup> parashihet, citoj: “të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”. Gjithashtu ligji për shërbime sociale dhe familjare i Kosovës<sup>19</sup> në nenin 11.25, përveç tjerash parasheh “paneli duhet të sigurohet se ka përputhshmëri me kërkesat e Konventës së Hagës mbi të Drejtën Private, Konventa mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimet jashtë vendit, si dhe të mundësojë procedurat e nevojshme ligjore për kryerjen e adoptimit ndërshtetërore siç përcaktohet nga Konventa e Hagës.

Legjislacioni i Kosovës, i cili përmban dispozita dhe rregullon adoptimin e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore është: Ligji për familje i Kosovës (Nr.2004/32); Ligji për shërbime sociale dhe familjare (Nr02/L-17); Udhëzimi administrativ për përbërjen dhe funksionimin e panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe adoptim Nr.12/2012 (në vijim UA për funksionin e panelit për adoptim nr.12/2012) etj.<sup>20</sup> Sa i përket Shqipërisë, për dallim nga Kosova, ajo është edhe nënshkruese e disa Konventave për të drejtat e fëmijëve dhe adoptimin e tyre. Është me rëndësi të ceket Konventa e Hagës mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimet jashtë vendit, (Ligji Nr.8624, datë 15.6.2000 për aderim të Shqipërisë në këtë Konventë), Konventa Evropiane për marrëdhënie me fëmijët (Ligji Nr.9359 datë 31.03.2005), etj.<sup>21</sup> Ndërsa, disa nga ligjet vendore që rregullojnë çështjen e birësimit/adoptimit janë: Kodi i familjes i Shqipërisë Nr.9062, 08.05.2003 ndryshuar në ligjin 134/2015 (në vijim KFSH),<sup>22</sup> Ligji për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptare të birësimit

---

<sup>18</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në fuqi prej 15.06.2008 (me amendamentet I-XXIV), Prishtinë, Gusht 2015, e disponueshme në: <https://www.kuvendikosoves.org/?cid=1.1058>

<sup>19</sup> Ligji për shërbimet sociale dhe familjare, Nr 02/L-17, gazeta zyrtare e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë (GZIPVK), Prishtinë, 1.9.2006, i disponueshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2447>

<sup>20</sup> U.A për rregullimin e procedurave të adoptimit për fëmijët pa përkujdesje prindërore, Nr. 09/2004, si dhe U.A për përbërjen dhe funksionimin e panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror.

<sup>21</sup> “Përmbledhje e akteve ndërkombëtare për drejtësinë, botim i qendrës së publikimeve zyrtare”, i disponueshëm në: <http://www.qbz.gov.al/botime/permbledhese%20e%20akteve%20nderkombetare%20per%20drejtesine.pdf>, 06.2010

<sup>22</sup> Kodi i familjes i Shqipërisë, fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë (RSH), Tiranë, 2015, nr. 220, i disponueshëm në [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/PDF-2015/220-2015.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/220-2015.pdf)

nr. 9695,19.3.2007, (ndryshuar me ligjin 10358,16.12.2010, dhe 132/2015,5.12.2015) (në vijim Ligji për birësim nr.9696), etj.<sup>23</sup>

Sikurse Shqipëria, po ashtu edhe Maqedonia është nënshkruese e Konventës së Hagës mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptim jashtë vendit, 20.IX.1995,<sup>24</sup> dhe përveç kësaj po ashtu edhe në Maqedoni janë në fuqi ligji edhe rregulla të cilat rregullojnë çështjen e adoptimit vendor dhe ndërkombëtar të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, siç janë: Ligji për familjen i Maqedonisë, Nr. 153, 20.10.2004 (në vijim LFM),<sup>25</sup> Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për adoptuesit e mundshëm, 1.X.2004,<sup>26</sup> Rregulloren për kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes elektronike të adoptuesve Nr. 10, datë: 25.01.2011 e ndryshuar me Rregulloren Nr.10-2831/3, datë 08.05.2012, etj.<sup>27</sup>

Në legjislacionin dhe teorinë juridike më së shpeshti me emërtimin “burimet e së drejtës” shënjohen burimet formale të së drejtës, respektivisht dispozitat juridike që përmbajnë norma të përgjithshme juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet shoqërore. Në këtë kuptim për burime të së drejtës familjare siç janë Kushtetuta, Konventat Ndërkombëtare, Ligji dhe aktet e tjera të përgjithshme. Me këtë rast, burim themelor i së drejtës familjare të Republikës së Maqedonisë paraqet Ligji për Familjen, meqë në tërësi dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse i rregullon marrëdhëniet familjare. Burimet plotësuese të së drejtës familjare rregullojnë vetëm një pjesë të raporteve familjare. Përveç akteve të përgjithshme juridike që paraqesin burim të drejtpërdrejtë të së drejtës familjare, si burim tjetër të së drejtës familjare paraqiten edhe praktika gjyqësore, traditat dhe shkenca juridike.

---

<sup>23</sup> Ligji për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptare të birësimit, fletorja zyrtare e RSH, Nr. 9695 Tiranë, 2015, nr. 220 i disponueshëm në <http://www.ikub.al/LIGJE/703190006/Article-Per-procedurat-e-biresimit-dhe-Komitetin-Shqiptare-te-Biresimit.aspx?cookiesEnabled=false>

<sup>24</sup> Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente, i disponueshëm në [https://hcch.net/en/states/hcch-members/details1/?sid=38\\_marre](https://hcch.net/en/states/hcch-members/details1/?sid=38_marre) më datë 27 korrik 2018.

<sup>25</sup> Ligji për familjen, teksti i konsoliduar, “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 153/2014, i disponueshëm në: <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Zakon-za-semejstvoto-20-10-2014-prechisten-tekst.pdf>

<sup>26</sup> Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrimit për adoptuesit e mundshëm “Gazeta Zyrtare e RM “ Nr.66.fq.77,e disponueshme në [http://www.mtps.gov.mk/WBStorage/Files/register\\_posvoiteli.pdf](http://www.mtps.gov.mk/WBStorage/Files/register_posvoiteli.pdf)

<sup>27</sup> Rregullorja e kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes elektronike të adoptuesve, nr. 10-2861/3, disponueshme në: [www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/pravilnik\\_poisvoitel.doc\\_08.05.2012](http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/pravilnik_poisvoitel.doc_08.05.2012)

#### **1.4. Kushtetuta si burim i së drejtës familjare**

Sipas fuqisë së saj juridike në hierarkinë e burimeve juridike Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë paraqet aktin më të lartë juridik. Kushtetuta përmban disa dispozita të cilat janë me rëndësi për të drejtën familjare dhe për rregullimin e raporteve familjare. Si parime bazë, këto dispozita janë themeli në bazë të së cilave rregullohen normat e së drejtës familjare. Me rëndësi të veçantë janë dispozitat që kanë të bëjnë me parimet e barazisë në bazë të së cilave qytetarët “janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës, prejardhjes nacionale dhe sociale, besimit politik dhe fetare dhe pozitës materiale dhe shoqërore” (neni 9 alinea 1). Me këtë dispozitë ndalohet çfarëdo lloj diskriminimi i qytetarëve në lidhje me këto raporte. Me këtë kuptim, qytetarët para Kushtetutës dhe ligjeve janë të njëjtë dhe të barabartë. Me rëndësi të veçantë për të drejtën familjare gjithsesi është edhe dispozita me të cilën garantohet respektimi dhe mbrojtja e privatësisë së jetës personale dhe familjare, si dhe dinjiteti dhe autoriteti (neni 25).

Me rëndësi të madhe është edhe dispozita me të cilën parashihet që shteti i siguron kujdes dhe mbrojtje të veçantë familjes (neni 40 alinea 1). Shkak për këtë është se familja paraqet institucionin më të rëndësishëm shoqëror që është vendimtar për zhvillimin e personalitetit dhe individit në shoqëri. Në këtë kuptim, Kushtetua parasheh që raportet juridike në çift, familje dhe bashkësi jashtëmartesore rregullohen me ligj (neni 40 alinea 2).

Në nenin 41 Kushtetuta e proklamon të drejtën e planifikimit të fëmijëve, respektivisht të drejtën e prindërimit të lirë dhe të përgjegjshëm, që shprehet në bazë të së drejtës së njeriut që lirshëm të vendosë për lindjen e fëmijëve, ndërsa shteti për shkak të zhvillimit harmonik, ekonomik dhe social udhëheq politikë humane të popullsisë. Përveç kësaj, Kushtetuta parasheh edhe dispozitë sipas së cilës prindërit kanë të drejtë dhe obligim që të kujdesen për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve, por njëkohësisht edhe fëmijët janë të obliguar që të kujdesen për prindërit e moshuar (neni 40 alinea 3). Së fundmi Kushtetuta parasheh se shteti siguron mbrojtje të veçantë të fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa përkujdes prindëror. Me këtë, roli i familjes për fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror zëvendësohet me institucionet shtetërore.

### **1.5. Ligji si burim i së drejtës familjare**

Burim më i rëndësishëm i të drejtës familjare në Republikën e Maqedonisë paraqet Ligji për Familjen i vitit 1992. Ky ligj bazohet në parimet e familjes, marrëdhëniet bashkëshortore dhe familjare nga Kushtetuta dhe paraqet kodifikim të parë të së drejtës familjare në legjislacionin e Maqedonisë. Ligji për Familjen është me rëndësi të veçantë për të drejtën familjare për shkak se paraqet aktin e parë të kodifikuar me të cilin në mënyrë integrale janë rregulluar raportet në bashkëshortësi, marrëdhëniet në mes prindërve dhe fëmijëve, adoptimin, kujdestarinë, mbajtjen në mes anëtarëve të familjes si dhe dhuna familjare, që nuk ishte rast në të kaluarën. Specifike dhe risi e këtij ligji është ajo se me përmbajtjen e tij përveç normave materiale juridike përfshinë edhe normat procedurale nga proceset gjyqësore në kontestet familjare (kontestet bashkëshortore, partneritetit si dhe kontestet e mbajtjes etj). Përveç Ligjit për Familje që paraqet burimin kryesor të së drejtës familjare, si burime plotësuese të së drejtës familjare paraqiten edhe: Ligji për fertilitetin biomedicinal, Ligji për evidencë amë, Ligji për emrin personal, Ligji për trashëgimi, Ligji për procedurën jashtëkontestimore, Ligji për procedurën kontestimore, Ligji për pronësinë dhe të drejtat e tjera reale, Ligji për Gjyqet etj.

### **1.6. Marrëveshjet ndërkombëtare si burim i së drejtës familjare**

Marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar nga Republika e Maqedonisë kanë fuqinë e ligjit dhe paraqesin pjesë të rregullimit të brendshëm juridik. Ato janë burime të së drejtës familjare kur me ata mbrohen dhe rregullohen disa të drejta të marrëdhënieve familjare, si p.sh: E drejta për martesë dhe familje, parimi i lirisë së lidhjes së martesës, si dhe mbrojtja juridike e familjes. Si burime më të rëndësishme të së drejtës familjare janë dokumentet themelore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, siç janë: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike, Konventa për ndërprerjen e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, Konventa për mbrojtjen e mëmësisë, Konventa për të drejtat e fëmijës, Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe protokolet e tyre e kështu me radhë. Nga marrëveshjet e theksuara ndërkombëtare, rëndësi më të madhe ka Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, shkelja eventuale e të cilave nga ana e shteteve nënshkruese vendos Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut e

themeluar në Strasburg në vitin 1959. Nga praktika e gjertanishme, Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut ka sjellë një numër të madh Aktgjykimesh që lidhen me aplikimin apo interpretimin nga Konventa e që kane të bëjnë me jetën familjare. Përveç marrëveshjeve ndërkombëtare shumëpalëshe - Konventat, si burime të së drejtës familjare, paraqiten edhe marrëveshjet e veçanta bilaterale të lidhura nga ana e Republikës së Maqedonisë me të cilat rregullohen disa çështje nga sfera e së drejtës familjare.

### **1.7. Praktika gjyqësore si burim i së drejtës familjare**

Në sistemin tonë juridik, i cili bëhet pjesë në të drejtën kontinentale, evropiane, praktika gjyqësore nuk paraqet burim formal të së drejtës. Kjo për shkak së vendimet gjyqësore në brendësinë e tyre nuk përmbajnë norma të përgjithshme juridike, por individuale, e që janë obligative vetëm për palët e rastit konkret. Për shkak të kësaj, për dallim nga e drejta precedente anglo-amerikane, në të drejtën tonë vendimet e ndonjë gjykate konkrete nuk janë obligative për gjykatat e tjera. Gjegjesisht, sipas legjislacionit tonë, gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti ynë, si dhe në bazë të bindjes së lirë gjyqësore. Nga këtu, vendime gjyqësore të instancave më të larta gjyqësore nuk janë obligative, e as për gjykatën e cila paraprakisht ka sjellë vendim të tillë, e as për gjykatat më të ulëta kur ata vendosin për të njëjtat raste. Megjithatë, vendimet e Gjykatës Supreme, dhe qëndrimet bazë dhe mendimet juridike, edhe përkundër faktit se nuk janë obligative, kanë ndikim moral të instancat më të ulëta gjyqësore, të cilat për shkak të mundësisë që t'i anulojnë apo t'i ndryshojnë vendimet e tyre në masën më të madhe i respektojnë.

Në të kaluarën, në kushtet kur një numër i madh i raporteve nuk kanë qenë të rregulluara dhe atëherë kur është krijuar sistemi juridik, roli i praktikave gjyqësore ka qenë shumë më i theksuar.

Sot roli i praktikës gjyqësore shumë rrallë paraqitet si burim i së drejtës, edhe atëherë vetëm në rastet kur ekzistojnë zbrazëtira juridike dhe kundërthënie në legjislacion. Në raste të këtilla praktika gjyqësore paraqitet si krijues i rregullit të ri juridik dhe paraqitet si burim sekondar i së drejtës. Në legjislacionin ekzistues roli i praktikës gjyqësore, veçanërisht është theksuar gjatë interpretimit të standardeve të përgjithshme juridike, si p.sh “interesi më i mirë i fëmijës”, “të

gjitha rrethanat e rastit”, “veçanërisht shkaqet e veçanta”, me ç’rast vjen në shprehje roli kreativ i praktikës gjyqësore.

### **1.8. Tradita si burim i së drejtës familjare**

Tradita paraqet rregull shoqëror kur paraqitet si rezultat i përsëritjes së gjatë i një sjelljeje të caktuar e që ka krijuar vetëdije për obligueshmërinë e saj në shoqëri. Në të drejtën familjare tradita, për dallim nga burimet e tjera formale nuk ka rëndësi të madhe. Megjithatë ajo mund të paraqitet si burim i së drejtës familjare në dy mënyra - të theksuar dhe të heshtur. Në rastin e parë ligjvënësi në mënyrë të theksuar e ka pranuar traditën dhe thirret në të. Në rastin e dytë ligjvënësi nuk e parasheh në mënyrë eksplicite traditën si burim i së drejtës, megjithatë në bazë të saj plotësohet zbrazëtira juridike e cila nuk është e rregulluar me ligj.

### **1.9. Shkenca juridike si burim i së drejtës familjare**

Shkenca juridike i përfshinë polemikat shkencore dhe profesionale, debatet shkencore rreth çështjeve të caktuara juridike, si dhe rezultatet dhe konkluzionet e fituara nga hulumtimet e bëra.

Në të kaluarën, në periudhën e së drejtës romake, shkenca ka paraqitur burim të së drejtës. Si rezultat i kësaj, ka ekzistuar obligimi i detyrueshëm për gjykatat që t’i respektojnë qëndrimet dhe mendimet e juristëve më në zë të kohës Romake. Sot, në shoqëritë bashkëkohore, shkenca nuk paraqet burim formal të së drejtës, për këtë shkak qëndrimet dhe mendimet e shkencës nuk janë obligative për ligjdhënësin dhe gjykatat. Megjithatë, shkenca juridike ka ndikim në të drejtën familjare, e cila shprehet përmes pjesëmarrjes në komisionet profesionale për hartimin dhe përpilimin e projektligjeve dhe akteve të tjera juridike, në të cilat inkorporohen propozimet nga shkenca. Ndikimi i shkencës shprehet edhe me ndihmën e publikimeve shkencore e profesionale e cila përmes analizimit dhe kritikave ndaj zgjidhjeve ekzistuese ligjore propozon zgjidhje të reja juridike.



## **1.10. Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

Mbrojtja e të drejtave familjare realizohet jo vetëm në nivel nacional por edhe në atë ndërkombëtar. Në bazë të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është ndërtuar sistem i mbrojtjes së të drejtave të garantuara nga Konventa, me çka është mundësuar edhe personat fizikë në mënyrë të drejtpërdrejtë të mund të kërkojnë mbrojtje juridike para një gjykate ndërkombëtare. Kjo është njëra ndër karakteristikat më të rëndësishme të Konventës Evropiane, e që jep mundësi edhe individit të bëhet palë para gjykatave ndërkombëtare, e që në të kaluarën kjo e drejtë ishte e rezervuar vetëm për shtetet. Rëndësia e kësaj Konvente është e madhe nga fakti se për herë të parë mundësohet që rastet e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e shteteve të bëhen lëndë shqyrtimi nga një gjykatë e pavarur ndërkombëtare të iniciuara nga një person fizik apo juridik. Kjo paraqet aktin më të rëndësishëm të këshillit të Evropës dhe ratifikimi i saj është kusht për anëtarësim në këtë organizatë ndërkombëtare, e cila ka për qëllim sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Në fillim kanë qenë të krijuara dy organe të mbikëqyrjes ndërkombëtare se si zbatohet Konventa dhe a shkelen dispozitat e saj. Ato organe ishin Komisioni Evropian për të drejtat e njeriut dhe Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut. Më vonë, me miratimin e protokolit nr. 11 në vitin 1994 dhe me hyrjen në fuqi të tij në vitin 1998 u bë reformë e rëndësishme me krijimin e gjykatës së përhershme evropiane me kompetenca obligative për të gjitha shtetet nënshkruese të konventës. Në pajtim me dispozitat e konventës, gjykata është kompetente: a) për interpretimin dhe zbatimin e protokoleve (neni 32 alinea 1), b) të vendosë në rast kontesti lidhur me kompetencën (neni 32 alinea 2); c) të vendosë për konteste mes shteteve anëtare nëse ndonjëra prej tyre i ka shkelur dispozitat e konventës dhe protokoleve plotësuese (neni 33); d) të japë mendime këshilluese për komitetin e ministrave të këshillit të Evropës (neni 47) dhe e) të vendosë për kërkesat e paraqitura individuale për mbrojtjen nga ana e individëve, organizatave jo qeveritare dhe grupeve të interesit në qoftë se konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të njohura dhe të mbrojtura nga Konventa dhe protokolet plotësuese (neni 34).

Që gjyqi të mund të veprojë në bazë të kërkesës së parashtruar për mbrojtje është e nevojshme të plotësohen dy kushte 1) të jenë shtjerrë të gjitha barërat juridike sipas legjislacionit të vendit dhe 2) kërkesa për mbrojtje të parashtrohet në afat prej 6 muajsh nga sjellja e vendimit të plotfuqishëm për lëndën e parashtruar. Nëse nuk janë plotësuar këto dy kushte gjykata i refuzon

kërkesat për mbrojtje. Në të kundërt procedura për mbrojtje përpara gjykatës përfundon me aktgjykim apo me marrëveshje të arritur. Aktgjykimet e gjykatës janë obligative për të gjitha shtetet nënshkruese, ndërsa komiteti i ministrave bën mbikëqyrjen e ekzekutimit të tyre (neni 46). Përveç obligimit që shteti të paguajë një shumë të caktuar të parave për shkeljen e shkaktuar, praktika e gjertanishme e gjykatës i obligon shtetet në mbikëqyrjen e komitetit të ndërmarrin masa në legjislacionin e vendit me çka do të ndërpritej dhe pengohet shkelja e mëtejme e konventës si dhe t'i mënjanojnë pasojat nga shkeljet e tilla.

Gjykata evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është e përbërë me nga një gjykatës nga secili shtet nënshkrues i konventës. Gjykatësit zgjidhen nga Kuvendi parlamentar i Këshillit të Evropës me propozim të listës me nga tre kandidatë nga çdo shtet nënshkrues me mandate prej gjashtë (6) vitesh më të drejtë rizgjedhjeje. Gjykata kompetencat e veta i realizon përmes këtyre formave: mbledhjeve të përgjithshme plenare, këshillit të lartë, seksionit, këshillit dhe komitetit. Lëndet gjykata i shqyrton para se gjithash nëpër këshilla prej tre gjyqtarëve, në këshille prej shtatë (7) gjyqtarëve, ndërsa instancë më e lartë është këshilli i lartë i përbërë nga shtatëmbëdhjetë (17) gjykatës. Në përbërjen e këshillave, gjegjësisht këshillit të lartë, hyjnë çdo herë gjykatësi i zgjedhur nga lista e shtetit të interesuar, apo në qoftë se kjo nuk është e mundur, atëherë person tjetër sipas zgjedhjes së shtetit të interesuar e që do ta realizojë funksionin e gjykatësit ad-hok.

### **1.11. Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në marrëdhëniet bashkëshortore dhe familjare**

E drejta për jetë familjare është e garantuar në nenin 8 të konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Në të parashikohet se çdokush ka të drejtë të mbrojtjes së jetës së tij private dhe familjare, të shtëpisë së tij dhe korrespondencës. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute, por se në konventën evropiane për të drejtat e njeriut janë parashikuar disa përkufizime. Kështu në nenin 8 alinea 2 parashihet se: “pushteti publik nuk duhet të përzihet në realizimin e kësaj të drejte, përveç nëse kjo ndërhyrje është e parashikuar me ligj dhe nëse paraqet masën e cila është në interes të sigurisë shtetërore dhe publike, mirëqenies ekonomike të vendit, ruajtjes së rendit dhe pengimit të veprave penale, mbrojtjes së shëndetit dhe moralit, apo mbrojtjes së lirive dhe të

drejtave të të tjerëve, në një shoqëri demokratike”. Që të mund gjykata ta pranojë padinë se është cenuar ndonjë e drejtë e garantuar me nenin 8 midis të cilave është edhe e drejta për jetë familjare, paditësi duhet të dëshmojë se e drejta e cenuar hyn në rrethin e të drejtave të cilat mbrohen me nenin 8. Kështu p.sh, në rastin Goskin kundër Britanisë së Madhe paditësi e ka bindur shumicën e gjykatësve të gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut se kërkesa e tij që t’i jepen informacione për ruajtjen e tij në shtëpi të fëmijëve pa prindër hyn në kuadrin e të drejtave të garantuara në nenin 8, respektivisht e drejta e mbrojtjes së jetës së tij private dhe familjare, a jo se ajo e drejtë është e lidhur vetëm me autorizimin e tij që të kërkojë informacion nga organet shtetërore që nuk bën pjesë në të drejtat e garantuara në nenin 8 të konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Me këtë rast që gjyqi të mund të veprojë sipas padisë, duhet të vërtetojë se shkelja e së drejtës së parashikuar në nenin 8 alinea 1 nuk është e arsyetuar për shkak të ekzistimit të shkaqeve të nënvizuara në nenin 8 alinea 2.

Koncepti i jetës familjare, përjeton evolucion të rëndësishëm gjatë kohës nga sjellja e Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut deri më sot. Ky koncept vazhdon të ndryshohet edhe më tej, për shkak të ndryshimeve të mëdha sociale në të gjitha sferat e jetës familjare, e që kanë ndikim edhe në rregullimin juridik të familjes në të gjitha vendet evropiane. Për shkak të transformimeve të këtilla bashkëshortore dhe familjare edhe gjykata evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ka pranuar qasje fleksibile në raport me çështjen e interpretimit të emërtimit dhe përmbajtjes së jetës familjare. Ky qëndrim është imponuar për shkak të ndryshimeve të shpejta të cilat shprehen përmes rritjes dramatike të shkurorëzimeve, bashkësive jashtëmartesore, dhe fëmijëve të lindur jashtëmartesore. Ndryshimet në konceptin e familjes, para se gjithash në marrëdhëniet prindërore janë edhe rezultat i zhvillimit të shpejtë të mjekësisë reproduktuese, e cila ka sjellë deri te një numër i madh i dilemave juridike dhe etike lidhur me konceptin e atësisë, amësisë dhe prindërimit. Për shkak të gjitha këtyre, në të gjitha shoqëritë bashkëkohore evropiane po ndryshon natyra e familjes, struktura dhe funksioni i saj, raportet e familjes me mjedisin social, si dhe raportet mes anëtarëve të familjes.

Gjykata Evropiane për të Drejta e Njeriut përcakton se a bëhet fjalë për “jetë familjare” sipas rrethanave të çdo rasti, me ç’rast parimi bazë nga i cili niset gjykata është ekzistimi i lidhjeve të afërta midis dy apo më shumë personave. Për shkak të faktit që gjykata i studion rrethanat për

çdo rast nuk është e mundur në mënyrë taksative të numërohen të gjitha situatat kur gjykata konsideron se ekziston “jeta familjare”. Megjithatë, duket pasur parasysh transformimet e mëdha gjatë dekadave të fundit në familje që solli deri tek evoluimi i praktikës gjyqësore të gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut mund të jepet një vlerësim i përgjithshëm se një numër gjithnjë e më i madh i lidhjeve sot e gëzon mbrojtjen e parashikuar në nenin 8 alinea 1 nga Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut.

## KAPITULLI II

### 2. Rregullimi juridik i marrëdhënieve familjare

Njëra ndër lëmitë më të rëndësishme ku Gjykata për të Drejtat e Njeriut ka vendosur gjatë dekadave të fundit në lidhje me marrëdhëniet familjare në veçanti në rastet kur prindërit e fëmija nuk kanë lidhur kurorë. Kjo është me rëndësi për shkak të faktit se në të gjitha të drejtat evropiane dukshëm rritet numri i bashkësive jashtëmartesore, si dhe i fëmijëve të lindur jashtë martesë (në vendet e Bashkimit Evropian tash me mbi 1/3 e fëmijëve që lindin janë fëmijë jashtëmartesorë, ndërsa në disa vende si në Estoni, Francë, Suedi dhe Bullgari numri i fëmijëve jashtëmartesorë është më i madh nga numri i fëmijëve të lindur në martesë). Në mënyrë të përgjithshme tendenca themelore në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është orientuar drejt përmirësimit të përhershëm të pozitës juridike e prindërve jashtëmartesorë dhe fëmijëve të tyre.

Në rastin Marks kundër Belgjikës (1979) paditësja në padi ka theksuar se, sipas legjislacionit të atëhershëm belg, për t'u përcaktuar mëmësia e nënës e cila nuk ka qenë në martesë, ajo është dashur që ta njohë fëmijën ose të zhvillohet procedurë gjyqësore për përcaktimin e mëmësisë. Në padi paditësja ka theksuar se kjo procedurë e kufizon mundësinë e saj që ta bartë pronën e saj për fëmijën dhe se nuk ka krijuar lidhje juridike midis fëmijës dhe familjes së tij. Vetëm po qe se paditësja do të lidhte kurorë apo do ta adoptonte fëmijën e vet atëherë ajo do të kishte të drejta të njëjta me fëmijët të cilët i kanë lindur në bashkësinë martesore. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vendosur se në këtë rast Belgjika ka bërë shkelje të nenit 8 (E drejta e jetës familjare) dhe nenit 14 (Ndalimi i diskriminimit) nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas Gjykatës jeta familjare midis nënës pa kurorë dhe fëmijës krijohet me lindjen dhe lidhjen biologjike që ekziston midis nënës dhe fëmijës. Kjo lidhje në mënyrë automatike shndërrohet në lidhje juridike, me çka mundësohet, siç thekson gjykata në rastin e procesit gjyqësor ndaj rastit "Marks" kundër Belgjikës "Fëmija të integrohet në familjen e tij nga

momenti i lindjes”. Pas këtij vendimi Belgjika e ka ndryshuar legjislacionin e vet, ndërsa ky rast merret si bazë për përmirësimin e pozitës së fëmijëve jashtëmartesorë.

## **2.1. E drejta që të dihet prejardhja e fëmijës**

Në praktikën gjyqësore të gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut janë të shpeshta rastet që kanë të bëjnë me të drejtën e fëmijës që ta dijë prejardhjen e tij. Kështu në rastin Mikulic kundër Kroacisë (2002) fëmija i lindur jashtë martese, së bashku me nënën e tij, ngritën padi për përcaktimin e atësisë. Paditësit në padinë e tyre drejtuar gjykatës kanë theksuar se legjislacioni kroat nuk e obligon mashkullin që t’i nënshtrohet testit të ADN-së. Gjykata nuk ka vendosur në lidhje me padinë për njohjen e atësisë kështu që fëmija ka mbetur në paqartësi sa i takon identitetin personal. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka sjellë vendim se në këtë rast Kroacia ka shkelur nenin 8 me të cilin mbrohet e drejta e jetës familjare. Gjykata ka konsideruar se legjislacioni kroat nuk ka siguruar balancë të drejtë midis të drejtës së paditësit që ta mënjanojë paqartësinë në lidhjen me identitetin personal dhe dëshirës së mashkullit që mos t’i nënshtrohet analizës së ADN-së.

Gjykata e Strasburgut shpesh vendos për shkeljen e të drejtës së privatësisë dhe jetës familjare, në kontekst të adoptimit. Në rastin Kigan kundër Irlandës (1994) paditësi ka theksuar se fëmija i tij është adoptuar pa dijeninë e tij dhe pa pëlqimin e tij, dhe se legjislacioni Irlandez nuk i ka dhënë mundësi as të caktohet si kujdestar i fëmijës. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka sjellë vendim se është shkelur e drejta e jetës familjare, para se gjithash për shkak të faktit se legjislacioni Irlandez ka lejuar që fëmija të jepet në adoptim menjëherë pas lindjes pa dijeninë e të atit. Gjendja e këtillë ka çuar në rrezikimin e zhvillimit adekuat të marrëdhënieve të paditësit me fëmijën e tij. Gjyqi ka sjellë vendim se Qeveria Irlandeze nuk ka ofruar argumente valide që kanë të bëjnë me mirëqenien e fëmijës që të mund të sillej vendim për adoptimin e fëmijës, me çka janë cenuar lidhjet familjare dhe e drejta e jetës familjare të paditësit.

Në rastin Zaped kundër Rumanisë (2015) bëhet fjalë për anulimin e adoptimit të një gruaje, me kërkesë të motrës së saj dhe atë 31 vjet pas vendosjes së adoptimit dhe 18 vjet pas vdekjes së

nënës e cila është paraqitur si adoptuese. Paditësja ka theksuar se anulimi i adoptimit ka qenë arbitrare dhe paraqet çrregullim disproporcional të jetës së saj familjare. Ajo ka theksuar se me nënën e saj ajo ka jetuar prej moshës 9 vjeçare dhe se raporti i tyre është bazuar në dashuri, respektim dhe ndihmesë. Përveç kësaj, ajo në padi ka theksuar se si rezultat i anulimit të adoptimit ajo ka humbur të drejtën e 5 hektarëve të tokës pjellore që i ka trashëguar nga nëna e saj. Në vendimin e saj Gjykata ka theksuar se anulimi i adoptimit ka qenë si rezultat i arsyetimit të paqartë dhe se nuk kanë ekzistuar shkaqe serioze dhe të arsyeshme për një masë të tillë radikale. Sipas kësaj Gjykata ka vendosur se anulimi i adoptimit ka paraqitur shkelje të së drejtës së jetës familjare të paditëses.

## **2.2 Domethënia dhe llojet e adoptimit**

Adoptimi paraqet institucion juridik dhe shoqërore në bazë të të cilit midis adoptuesit dhe të adoptuarit krijohen raporte si ato që krijohen me lindjen apo marrëdhënie që ekzistojnë midis prindërve dhe fëmijëve. Për dallim nga raporti natyral prindërore, adoptimi krijohet në mënyrë formale me akt juridik. Për nga esenca adoptimi paraqet formën më të mirë të mbrojtjes së fëmijëve pa prindër apo kujdes prindëror, meqë në këtë mënyrë mundësohet që fëmija të krijojë familje. Për dallim nga ky botëkuptim, që është virtyt i legjislacioneve familjare moderne, në të kaluarën adoptimi në radhë të parë është vendosur me interes të adoptuesit me qëllim të vazhdimit të trashëgimisë dhe ruajtjes së pasurisë në kuadër të familjes.

Në teorinë dhe praktikën juridike, në varësi të raporteve që krijohen, si dhe vazhdueshmëria e tyre janë të njohura dy lloje të adoptimit, adoptimi i plotë dhe jo i plotë. Nën ndikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, numër gjithnjë e më i madh i legjislacioneve familjare në reformat e tyre e parashohin vetëm adoptimin e plotë. Përkundër kësaj tendence të shoqërive moderne, e drejta jonë familjare ende i parashikon të dyja llojet e adoptimit atë të plotë dhe jo të plotë. Sipas Ligjit për Trashëgimi, se çfarë raporti do të vendoset me adoptimin, gjegjësisht a do të themelohet adoptimi i plotë apo jo i plotë para se gjithash varet nga vullneti i adoptuesit, respektivisht të prindërve të fëmijës i cili adoptohet, apo vetë fëmijës nëse është i moshës mbi 12 vjeçare (neni 95 alinea 2).

Me adoptimin e plotë midis adoptuesit dhe familjes së tij nga njëra anë dhe të adoptuarit dhe familjes së tij krijohen të drejta dhe detyrime siç ekzistojnë midis familjarëve të gjakut. Për shkak të kësaj, raportet që krijohen me adoptimin e plotë janë të karakterit të përhershëm dhe ato nuk mund të ndërpriten. Nga ana tjetër, me adoptimin e plotë ndërpriten të drejtat e ndërsjella dhe detyrimet midis fëmijës së adoptuar dhe familjes së tij paraprake. Me këtë formë të adoptimit ndërpriten të gjitha të drejtat dhe detyrimet midis fëmijës së adoptuar dhe prindërve biologjikë, duke përfshirë këtu dhe të drejtën e trashëgimisë. Kjo për shkak se me adoptimin e plotë të drejtat trashëgimore të të adoptuarit dhe familjes së tij ndaj adoptuesit dhe familjes së tij janë të barabarta me të drejtat trashëgimore që ekzistojnë midis të afërmeve të gjakut.

Me adoptimin jo të plotë midis adoptuesit dhe të adoptuarit krijohen raporte si ato mes prindit dhe fëmijës. Midis të adoptuarit dhe të afërmeve të adoptuesit nuk krijohen raporte familjare dhe i adoptuari nuk fiton kurrfarë të drejtash dhe detyrimesh ndaj tyre. Për shkak të kësaj midis vete mund të trashëgohen vetëm adoptuesi dhe i adoptuari dhe familja e tij. Shkaku kryesor për këtë është fakti se te adoptimi jo i plotë nuk ndërpritet se ekzistuar lidhja e gjakut mes të adoptuarit dhe familjes së tij biologjike. Si rezultat i kësaj i adoptuari edhe më tej i ruan disa të drejta por edhe detyrime ndaj familjes së tij të mëparshme, përfshirë këtu edhe të drejtën e trashëgimisë. Për dallim nga adoptimi i plotë, te adoptimi jo i plotë të drejtat trashëgimore të adoptuarit ndaj adoptuesit mund të kufizohen apo plotësisht të përjashtohen në qoftë se në momentin e adoptimit adoptuesi ka fëmijë të tij biologjikë. Në qoftë se si adoptues në rastin e adoptimit jo të plotë paraqiten partnerë bashkëshortorë, të drejtat trashëgimore të adoptuarit mund të përcaktohen në mënyrë të ndryshme veç e veç ndaj çdonjërit. Në këtë kuptim, nëse të drejtat trashëgimore të të adoptuarit kanë qenë të kufizuara apo të përjashtuara, adoptuesi nuk mund ta trashëgojë të adoptuarin dhe familjarët e tij në bazë të rregullave të trashëgimisë ligjore. Së fundmi adoptimi jo i plotë mund të ndërpritet për shkak se paraqet raporte të cilat nuk janë të karakterit të përhershëm.



## 2.3 Kushtet e adoptimit

Për vendosjen e adoptimit të plotë apo jo të plotë, duhet të plotësohen disa kushte të paraparë me Ligj. Në shkencën e së drejtës familjare këto kushte janë të ndara në dy grupe: (1) Kushtet qenësore, për themelimin e adoptimit dhe (2) Kushtet e plotfuqishmërisë së adoptimit.

Kushtet qenësore janë ato kushte pa të cilat nuk mund të vihet deri te adoptimi. Në këtë grup të kushteve bëjnë pjesë: (1) Pjesëmarrja e personave të caktuar të parashikuar në Ligjin për themelimin e adoptimit; (2) Deklaratë për pajtim të pjesëmarrësve për vendosjen e adoptimit dhe (3) Pjesëmarrje e organit kompetent në procedurën e adoptimit. Për vendosjen e adoptimit ligjvënësi parasheh pjesëmarrjen e obligueshme të adoptuesit dhe të të adoptuarit, si dhe të përfaqësuesve të tij ligjorë, prindërit apo përfaqësuesi ligjor. Në këtë kuptim, gjatë themelimit të adoptimit është e nevojshme prezenca e adoptuesit, partnerit të tij bashkëshortor, prindërit, gjegjësisht përfaqësuesi ligjor i të adoptuarit, si dhe të adoptuarit nëse është i moshës mbi 12 vjeçare. Megjithatë në raste të caktuara nuk është e obligueshme prania e të dy partnerëve bashkëshortorë. Ky është rasti kur partneri bashkëshortor i adoptuesit nuk paraqitet si adoptues, dhe nëse pajtueshmërinë e vet për adoptim e ka dhënë para Qendrës për Punë Sociale në proces, me të cilin patjetër duhet të theksohen adoptuesi dhe i adoptuari, gjatë procedurës së vendosjes së adoptimit mund të marrin pjesë të dy prindërit apo njëri prej tyre. Kur fëmija për çfarëdo shkaqesh është vendosur nën kujdestari atëherë prania e tij është e obligueshme. Pajtueshmëria e pjesëmarrësve në procedurë gjithashtu është kusht qenësore për themelimin e adoptimit. Ligji për të Drejtën Familjare në mënyrë precize i rregullon mënyrat e deklarimit të vullnetit nga ana e të gjithë pjesëmarrësve, e në raste të caktuara është e domosdoshme edhe pajtueshmëria e Komisionit si organ kompetent për adoptim. Në qoftë se mungon deklarimi i vullnetit të një pjesëmarrësi në procedurë nuk do të vihet deri te adoptimi. Pjesëmarrja e Organit Kompetent shtetëror para të cilit udhëhiqet procedura dhe i cili e sjell vendimin për themelimin e adoptimit ka rëndësi konstitutive. Kjo për shkakun se përveç Organit të përcaktuar ligjor te adoptimi as që mund të vihet. Në këtë kuptim Ligji për të Drejtën Familjare në mënyrë taksative parasheh se adoptimi bëhet përpara Komisionit (neni 97). Komisioni përbëhet prej 15 anëtarë të emëruar nga ministër për Punë dhe Politike Sociale. Komisioni punon në përbërje prej 5 anëtarësh të cilët zgjidhen në ditën e mbajtjes së çdo mbledhje në mënyrë elektronike nga të gjithë anëtarët e komisionit. Anëtari i Komisionit mund të jetë personi që ka të kryer shkollim të lartë dhe përvojë

pune së paku 5 vite në këtë lëmi. Komisioni në përbërjen e tij patjetër duhet të këtë jurist, pedagog, dhe punëtor social, të cilët përvojën e punës e kanë ndërtuar në këtë lëmi. Mandati i anëtarëve të Komisionit është dy vjet me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Kryetari i Komisionit zgjidhet nga anëtarët e Komisionit në mënyrë elektronike në ditën e mbajtjes së çdo mbledhjeje. Komisioni punon në mënyrë të pavarur dhe vendimet i sjellë në mënyrë të njëzëshme. Për punën e vet Komisioni çdo tre muaj e njofton, ndërsa çdo vit paraqet raport për punën e vet deri te Ministri për Punë dhe Politike Sociale.

## **2.4 Kushtet për plotfuqishmërinë e adoptimit**

Me kushtet për plotfuqishmërinë e adoptimit rregullohen kushtet pa të cilat adoptimi nuk mund të jetë i plotfuqishëm. Ato kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e të adoptuarit, adoptuesit, kushtet e përbashkëta që kanë të bëjnë me të adoptuarin dhe adoptuesin, pajtueshmërinë e prindërve dhe të fëmijës, gjegjësisht kujdestarit dhe pëlqimi i fëmijës nëse është i moshës mbi 12 vjeçare dhe procedura e mënyra e themelimit të adoptimit të përcaktuar me Ligj.

## **2.5 I adoptuari**

I adoptuari është personi në interes të të cilit vendoset adoptimi. Ligji për Familjen përcakton se vetëm personi jo madhor mund të adoptohet (neni 96). Kjo zgjidhje është përkrahur në pjesën më të madhe të legjislacioneve në të drejtën krahasimore, nga fakti se adoptimi si formë më e përshtatshme e mbrojtjes në radhë të parë është dedikuar për fëmijët pa përkujdes prindërore. Fëmijët madhorë me mbushjen e moshës 18 vjeçare janë të aftë vetë të kujdesen për veten, të drejtat dhe interesat e tyre si dhe të hyjnë në martesë, nga këtu ata nuk kanë nevojë që të adoptohen. Megjithatë, disa legjislacione lejojnë që edhe fëmija madhor të mund të adoptohet siç është rasti i Gjermanisë dhe Greqisë. Përveç moshës fëmija jo madhor nuk mund të adoptohet në qoftë se është në lidhje gjaku me adoptuesin. Pengesë ligjore për adoptim paraqet lidhja e gjakut në linjë të drejtë pavarësisht shkallës dhe lidhjes familjare anësore deri në shkallën e dytë. Në këtë kuptim Ligji për të Drejtën Familjare parasheh se nuk mund të adoptohen familjarë në linjë të parë e as vëllai e motra (neni 101). Përveç kufirit të ndarë të moshës të parashikuar për fëmijën e mitur, Legjislacioni ynë e rregullon edhe kufirin e poshtëm të fëmijës i cili mund të adoptohet.

Në këtë drejtim, adoptimi i fëmijës mund të vendoset më së hershmi pas përmbushjes së tre muajve moshe.

## 2.6 Adoptuesi

Sipas të drejtës sonë familjare adoptuesi mund të jetë personi i moshës madhore dhe me aftësi juridike të veprimit. Personi i moshës madhore të cilit i është marrë aftësia e veprimit juridik apo i është kufizuar nuk mund të jetë adoptues. Adoptuesi gjithashtu duhet të ketë cilësinë që do ta bënin të aftë për ushtrimin e të drejtës prindërore dhe të mos jetë më i vjetër se 45 vjet. Në raste të jashtëzakonshme adoptuesi mund të jetë edhe personi mbi moshën 45 vjeçare, po në këtë rast dallimi në moshë midis të adoptuarit dhe adoptuesit nuk duhet të jetë mbi 45 vjet. Çiftet bashkëshortore mund të paraqiten si adoptues në qoftë se njëri prej bashkëshortëve nuk e kalon moshën e përcaktuar. Përveç kushteve që janë të lidhura me subjektivitetin dhe moshën, ligjvënësi për zgjedhjen e adoptuesit parasheh edhe një sërë kriteresh nga plotësimi i të cilave varet edhe zgjedhja për adoptues: si gjendja shëndetësore, statusi social, kushtet materiale, kushtet e banimit, koha e pritjes, shkalla e arsimimit, statusi bashkëshortore dhe nënshtetësia.

Ligjvënësi në mënyrë taksative parasheh edhe një sërë rrethanash me ekzistimin e të cilave adoptues nuk mund të jetë personi: (a) të cilit i është marrë apo i është kufizuar e drejta prindërore, si dhe personi të cilit i është shqiptuar dënimi për vepër penale në kohëzgjatje më shumë se 6 muaj; (b) të cilit i është marrë apo i është kufizuar aftësia e veprimit juridik; (c) personi për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se pozitën e adoptuesit do ta shfrytëzojë në dëm të të adoptuarit; (d) personi i cili vuan nga sëmundje shpirtërore apo personi me të meta në zhvillimin intelektual si dhe personi që vuan nga sëmundja e cila mund ta vë në rrezik shëndetin dhe jetën e të adoptuarit; (e) personi me të meta fizike të asaj shkalle të cilat e vënë në pikëpyetje aftësinë e tij për t'u kujdesur për të adoptuarin; (f) personi i cili është më i vjetër se 45 vjet (g) personi i cili është i varur nga droga apo substanca të tjera psikotropike apo alkooli; (j) personi i cili vuan nga një sëmundje e rëndë kronike apo është i sëmurë nga sëmundje e pashërueshme infektive dhe (l) personi për të cilin mendimi i trupit profesional të Qendrës Sociale është negativ që ai person do të mund të ishte prind i mirë.

Në të drejtën tonë si adoptues mund të paraqitet vetëm një person. Kjo buron nga dispozita ligjore sipas së cilës askush nuk mund të adoptohet nga më shumë persona, kur vetëm në rastet kur adoptues paraqiten partnerët bashkëshortorë (neni 98). Nga kjo dispozitë buron se vetëm partnerët bashkëshortorë mund të paraqiten së bashku si adoptues të një personi të njëjtë. Përjashtim bën rasti kur njëri partner bashkëshortor e adopton fëmijën e partnerit të tij nga bashkëshortësia e mëhershme. Po qe se njëri nga partnerët bashkëshortorë dëshiron të adoptojë fëmijë sipas të drejtës sonë duhet të merret pëlqim nga partneri tjetër bashkëshortore.

Sipas rregullit, adoptues mund të jetë vetëm shtetasi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në raste të veçanta si adoptues mund të paraqitet edhe shtetasi i huaj. Në rastet kur si adoptues paraqitet shtetasi i huaj, është e nevojshme të shihet legjislacioni i vendit të adoptuesit që ka të bëjë me adoptimin. Në këto raste vendimin e jep Komisioni kur janë shtjerrë mundësitë që i mituri të mund të adoptohet nga shtetas i vendit tonë.

## **2.7 Kusht i përbashkët për të adoptuarin dhe adoptuesin**

Ekzistimi i dallimit në moshë është kushti i tretë për vendosjen e adoptimit, i cili është i përbashkët dhe ka të bëjë si me të adoptuarin ashtu edhe me adoptuesin. Në këtë kushtim, ligjvënësi ka parashikuar se adoptues mund të jetë personi i cili së paku 18 vjet është më i vjetër se i adoptuari. Kufizimi i këtillë është logjik duke pasur parasysh se adoptuesi duhet të luaj rolin e prindit. Kufizimet e caktuara në lidhje me moshën dhe dallimi në vite midis të adoptuarit dhe adoptuesit nuk zbatohen në rastet kur fëmijën e adopton partneri bashkëshortor i fëmijës. Sipas Konventës Evropiane për adoptim të fëmijëve nga viti 1967 e sjell nga Këshilli i Evropës është parashikuar se adoptuesi nuk duhet të jetë më i ri se 21 vjet e më i vjetër se 35 vjet.

## **2.8 Pëlqimi i prindërve të fëmijës i cili adoptohet dhe i të adoptuarit**

Si kusht për adoptim të plotfuqishëm është edhe pëlqimi i prindërve të fëmijës që fëmija i tyre të mund të adoptohet. Në rastet kur të dy partnerët bashkëshortorë e ushtrojnë të drejtën e prindërimit atëherë është i nevojshëm pëlqimi i ndërsjellët nga të dy prindërit. Megjithatë, kur të drejtën e prindërimit ndaj fëmijës të mitur e ushtron vetëm njëri nga prindërit, nga shkaku se

njëri prind është i vdekur apo i panjohur, atëherë pëlqim jep vetëm njëri prind. Në qoftë se prindi është i moshës jo madhore përkrah pëlqimit të tij është i nevojshëm edhe pëlqimi i përfaqësuesit ligjor. Sipas të drejtës sonë nuk është i nevojshëm pëlqimi i prindit të cilit i është marrë apo i është kufizuar e drejta e veprimit juridik. Nuk është i nevojshëm pëlqimi edhe nga prindërit për fëmijë i cili 9 muaj është i vendosur në institucion apo familje tjetër e të cilët nuk kanë treguar interes për fëmijën. Qendra për Punë Sociale është e obliguar që për çdo dy muaj, së paku tre herë me shkrim ta ftojë prindin dhe t'ia vë në dije pasojat, në qoftë se nuk e merr nën kujdes fëmijën e me ç'rast formulohet edhe procesverbal. Pas kalimit të këtij afati Qendra për Punë Sociale në afat prej 5 ditësh është e obliguar që ta thërrasë prindin dhe ta njoftojë që në afat prej 10 ditësh pas pranimit të njoftimit ta marrë nën kujdes fëmijën ose të jap pëlqim për adoptimin e tij. Në të kundërt, do të konsiderohet se prindi është pajtuar që fëmija të jepet për adoptim (neni 103 alinea 5).

Përveç rasteve të përmendura, ligji parasheh se nuk është i nevojshëm pëlqimi as nga i adoptuari i cili deri në momentin e adoptimit ka jetuar në familjen e adoptuesit para plotësimit të moshës 12 vjeçare. Gjithashtu nuk është i nevojshëm pëlqimi nga personi të cilin nëna e ka shënjestruar si prind të fëmijës të lindur jashtë martese, e i cili në afat prej 3 muajsh nga lindja e fëmijës nuk ka ngritur procedurë për pranimin e atij fëmije apo për përcaktimin e atësisë në lidhje atë fëmijë.

Prindërit, gjegjësisht prindi i cili vetë e ushtron të drejtën prindërore, pëlqimin për adoptimin e fëmijës mund ta japin edhe paraprakisht para Qendrës për Punë Sociale e cila është kompetente në bazë të vendit ku jetojnë ende pa e përcaktuar adoptuesin. Megjithatë në qoftë se fëmija nuk i ka të gjallë prindërit, pëlqimin që të mund të adoptohet fëmija mund japin të afërmit në vijë të drejtë dhe të tërthortë.

Në qoftë se prindi i cili e jep pëlqimin që fëmija të jepet në adoptim nuk di shkrim, lexim, deklaratën për pajtueshmëri e jep në formë të shkruar në procesverbal në lokalet e Qendrës për Punë Sociale dhe në prani të ekipit profesional të Qendrës. Deklaratën e nënshkruajnë prindërit të cilët në vend të nënshkrimit në deklaratën për pajtueshmëri do të vendosë gisht respektivisht do të vendosë gishtin tregues.

Ligji në mënyrë precize e rregullon përmbajtjen e deklaratës për pajtueshmëri. Në këtë kuptim ajo duhet të përmbajë të dhënat e emrit, datën dhe vendin e lindjes, vendin dhe adresën e

vendbanimit, përkatësinë etnike, numrin amzë dhe numrin e letërnjoftimit të prindit apo të kujdestarit; emrin personal, vendin dhe datën e lindjes të fëmijës i cili adoptohet dhe a është fëmija i lindur në martesë apo jashtë martese.

Pëlqimin për adoptim prindërit mund ta japin pas plotësimit e moshës 3 mujore të fëmijës. Adoptimi i fëmijës mund të themelohet nëse pas mbushjes së moshës 3 mujore. Pëlqimi për adoptim mund të tërhiqet deri në momentin e sjelljes së vendimit për vendosjen e fëmijës në familjen e adoptuesve, për shkak të rregullimit të procedurës së adoptimit.

### **Pëlqimi i të adoptuarit**

Pëlqimi i të adoptuarit për themelimin e adoptimit është kusht për plotfuqishmërinë e aktit të adoptimit te rastet kur fëmija i mitur është i moshës mbi 12 vjeçare. Kjo e drejtë e fëmijës të mitur buron nga mbrojtja e gjithnjë e më e madhe e fëmijëve, si edhe e përfaqimit të Konventës se fëmija duhet vetë të vendosë për çështje që kanë të bëjnë me të, midis të cilave bën pjesë edhe adoptimi. Për suksesin e adoptimit faktorë me rëndësi është edhe mendimi i fëmijës për adoptuesit e tij dhe veçoritë e tyre të karaktereve.

## **2.9 Procedura e adoptimit**

Procedura për vendosjen ose themelimin e adoptimit fillon me paraqitjen e kërkesë deri te Komisioni nga ana e personit i cili dëshiron të adoptojë fëmijë të mitur. Deri te komisioni dërgohen dokumentet e përcaktuara me rregulloren për mbajtjen e evidencës për fëmijët e adoptuar dhe dokumentet për adoptim. Këto dokumente janë të vlefshme një (1) vit nga dita e lëshimit. Qendra për Punë Sociale është e obliguar që me shkrim t'i njoftojë dy (2) muaj me herët para kalimit të afatit. Në të kundërtën Qendra për Punë Sociale i paraqet propozim Komisionit për shlyerjen nga regjistri si adoptues të mundshëm. Po qe se personi dëshiron të adoptojë fëmijë jashtë vendit, pëlqim për këtë jep Komisioni me propozim të Qendrës për Punë Sociale, në bazë të vlerësimit për përshtatshmërinë e adoptuesit dhe për motivet për adoptim.

Pas pranimit të kërkesës me dokumentacionin, Komisioni bën shqyrtimin e dokumenteve dhe në momentin që konstaton se dokumentet janë të kompletuara, kopjen nga kërkesa, së bashku me kopjet nga dokumentacioni i plotë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës paraqet

deri te Qendra për Punë Sociale kompetente në bazë të vendbanimit të ushtruesve të kërkesës për adoptim.

Qendra për Punë Sociale pas kryerjes së punëve lidhur me përcjelljen e rregullt të adoptuesve për shkak të përcaktimit të përshtatshmërisë së tyre si dhe për motivet e të njëjtëve në afat prej 10 ditësh të gjitha dokumentet së bashku me mendimin e trupit profesional me propozimin për regjistrimin në regjistrin e adoptuesve të mundshëm ia dërgojnë Komisionit. Komisioni në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të akteve të theksuara sjell vendim dhe bën regjistrimin në regjistrin e adoptuesve të mundshëm nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë ligj. Në qoftë se Komisioni vëren mangësi lëndën e dërgon deri te Qendra për Punë Sociale kompetente dhe të njëjtën e obligon që në afat prej 5 ditësh t'i mënjanojë mangësitë dhe lëndën t'ia kthejë Komisionit.

Komisioni do të sjellë vendim për shlyerje nga regjistri i adoptuesve të mundshëm: pas themelimit të aktit të adoptimit, nëse përcakton rrethana për shkak të të cilave aplikuesi nuk mund të jetë adoptues, në qoftë se ai e tërheq kërkesën si dhe në rastet kur i njëjti themelon marrëdhënie bashkëshortore apo shkurorëzohet. Qendra për Punë Sociale në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të vendimit bën arkivimin e të dhënave të adoptuesit në programin për zgjedhjen e adoptuesit më të përshtatshëm në formë elektronike. Në procedurën e adoptimit, Qendra për Punë Sociale i përcjellë personat e mitur pa prindër dhe pa përkujdes prindërore dhe bën propozim për regjistrimin në regjistrin e të adoptuarve të cilin e dërgon deri te Komisioni.

Komisioni pas marrjes së propozimit e paraqet raportin për gjendjen shëndetësore të fëmijës deri te Komisioni për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të fëmijëve pa përkujdes prindëror e që është e obliguar në afat prej 10 ditësh të paraqesë mendim dhe vlerësim për gjendjen shëndetësore të fëmijës. Komisioni është i obliguar që në afat prej 15 ditësh pas pranimit të akteve të bëjë regjistrimin në regjistrin e adoptuesve të mundshëm. Një (1) kopje të vendimit së bashku me të gjitha kopjet e dokumentacionit, Komisioni menjëherë i dërgon deri te Qendra kompetente për Punë Sociale, ndërsa ushtruesin e kërkesës e njofton për regjistrimin e kryer. Qendra për Punë Sociale në afat prej 3 ditësh pas marrjes së punëve nga alinea 1 e këtij neni bën evidentimin e të dhënave në program.

Pas regjistrimit të të dhënave për adoptuesin e mundshëm në program, Komisioni në mbledhjen e tij të parë të ardhshme bën zgjedhjen e adoptuesit më të përshtatshëm në mënyrë elektronike nga 3 të ranguarit e parë në listën e programit.

Për zgjedhjen e kryer Komisioni e njofton Qendrën për Punë Sociale e cila është kujdestare e fëmijës dhe varësisht nga vendi i vendbanimit të adoptuesit të zgjedhur do të kërkojë kujdestari për fëmijën e caktuar dhe atë ta bëjë Qendra për Punë Sociale nga ku është adoptuesi. Me këtë përfundojnë të gjitha të drejtat dhe obligimet e Qendrës për Punë Sociale nën kujdestarinë e së cilës ka qenë fëmija.

Pas kryerjes së punëve paraprake Komisioni sjell vendim për vendosjen e fëmijës në familje e adoptuesve dhe menjëherë atë ia dërgon Qendrës për Punë Sociale.



## KAPITULI III

### 3. Aspektet krahasuese në mes shteteve të rajonit për adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve

Adoptimi ndërkombëtar i fëmijëve është ndihmesë për adoptimin kombëtar. Parimisht, fëmija duhet të adaptohet në vendin e tij. Adoptimi ndërkombëtar bëhet pasi të jetë kërkuar pa asnjë rezultat, një zgjedhje e kënaqshme për të miturit në vendin e tij të origjinës. Në interes të të miturit, autoritet kompetente do të kontrollojnë që kjo kërkesë të bëhet pa vonesa të pajustificueshme.<sup>28</sup>

Përveç themelimit të adoptimit midis shtetasve të vendit, në teorinë dhe praktikën-familjare është e njohur edhe e drejta e të huajit që të adoptojë shtetasin e vendit, i huaji të adoptohet nga shtetasi i vendit apo i huaji të adoptohet nga i huaji, i njohur si adoptim me element të huaj apo adoptim ndërkombëtar.<sup>29</sup>

Kur marrëdhënia juridiko-private me element të huaj njëkohësisht rregullohen me burime nacionale (ligje) të një shteti dhe me burime ndërkombëtare (konventa) atëherë aplikohen konventat ndërkombëtare. Meqë me konventë ndërkombëtare rregullohet marrëdhënie juridiko-private konkrete (speciale) me elementë të huaj, me shpalljen dhe hyrjen e saj në fuqi shndërrohet në ligj special “Lex specialis”, ndërsa gjatë ekzekutimit të ligjit të përgjithshëm dhe atij special vlen rregullat “Lex specialis derogat legi generali “ (Ligji special e abrogon ligjin e përgjithshëm – general ).<sup>30</sup> Aplikimi i konventës ndërkombëtar ndërmjet shteteve nënshkruese (e jo i ligjit) është i detyrueshëm edhe për shkak të respektimit të parimit “pacta sunt servanda”. Pra, shtetet janë të detyruara t’i përmbushin detyrimet e marra ndërkombëtare.<sup>31</sup>

---

<sup>28</sup> Arta Selmani, “Adoptimi në legjislacionin pozitiv të Republikës së Maqedonisë dhe në të drejtat krahasuese të disa shteteve të rajonit”, Universiteti i EJL, Tetovë, 2011, f.47

<sup>29</sup> Ibid, f.39

<sup>30</sup> Asllan Bilalli, Hajredin Kuci, E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 2011, f.89

<sup>31</sup> Asllan Bilalli, Hajredin Kuci, E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë, 2012, f.89

Në vijim, janë paraqitur krahasimet midis Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë lidhur me adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve: të adoptuarin, adoptuesin, si dhe procedurat lidhur me adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore.

Vetëm i mituri mund të adoptohet. Ky është një koncept i njohur në legjislacionin e Kosovës, e po ashtu edhe të shteteve të rajonit, prandaj vendosja e fëmijës së braktisur pa përkujdesje prindërore në një familje adoptuese është element kyç për të ardhmen e tij.

Në vijim kemi paraqitur termin “I adoptuar/I birësuar”, sipas legjislacionit të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Sipas legjislacionit të Kosovës “vetëm fëmija i mitur mund të adoptohet”, (Neni 174 i LFK-së). Në rast se fëmija është në moshë mbi 10 vjeç, gjykata do të marrë parasysh posaçërisht nevojat emocionale dhe dëshirat e fëmijës. Nëse e mendon të nevojshme, gjykata do të marrë parasysh mendimin e ekspertëve, (Neni 144 dhe 168 i LFK).

Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë termin “i adoptuar” e përdor si “i birësuar”, kështu sipas nenit 3 par.3 të “Ligjit” për procedurat e birësimit dhe komitetit shqiptar të birësimit termi “i birësuar” do të thotë fëmija i privuar ose jo nga mjedisi familjar, i cili, nëpërmjet birësimit, vendoset në një familje tjetër, për t’u rritur dhe edukuar nga birësuesit si të ishte fëmija i tyre biologjik. Ndërsa birësohet vetëm i mituri, (Neni 241 i Kodit të Familjes së Shqipërisë).

Sipas nenit 96 të Ligjit për Familjen të Maqedonisë, “vetëm i mituri mund të adaptohet”.

Ngase u tha më lart, shihet se në legjislacionin e Kosovës dhe Maqedonisë përdoret termi “i adoptuar”, ndërsa në legjislacionin e Shqipërisë përdoret termi “i birësuar”.<sup>32</sup>

Kryesisht po jo gjithmonë adoptojnë fëmijë personat që nuk kanë fëmijë biologjikë, pra adoptimi lejohet edhe për persona të cilët kanë fëmijë të tyre biologjikë e të cilët plotësojnë kushtet për adoptim të fëmijëve. Po ashtu ka raste kur personat nuk janë në lidhje martesore shprehin dëshirën për të rritur fëmijë të adoptuar. Legjislacioni në fuqi qoftë vendor apo ndërkombëtar përcakton se cilët persona mund të jenë adoptues. Se cilët persona mund të jenë adoptues

---

<sup>32</sup> Duke mos dashur t’i iket termit të përdorur nga autorët dhe ligjvënësit e Shqipërisë, në këtë punim, në pjesën ku flitet për adoptimin e fëmijëve nga Shqipëria, kemi përdorur termin “birësim” e jo adoptim.

(birësues) apo palë adoptuese, sipas legjislacionit të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë është paraqitur në vijim.

Sipas nenit 175 dhe 176 të Ligjit të Familjes të Kosovës palë adoptuese mund të jetë edhe personi që e ka aftësinë për të vepruar dhe që i ka cilësitë personale të nevojshme për ushtrimin e suksesshëm të të drejtave dhe detyrimeve prindërore dhe i cili mund të ketë arritur moshën 21 vjeç. Nëse janë bashkëshortë që duan të adoptojnë fëmijë atëherë njëri nga bashkëshortët duhet të ketë arritur moshën 25 vjeç, ndërsa tjetri bashkëshort duhet të ketë arritur moshën 21 vjeç. Vlen të ceket se ky ligj e as legjislacioni tjetër në fuqi nuk e përcakton në mënyrë specifike nëse mund të adaptojnë fëmijë qifti i të njëjtës gjini (homoseksual).

Sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë termi “birësues” është personi / personat që, nëpërmjet birësimit, marrin fëmijë të privuar ose jo nga mjedisi familjar, duke i trajtuar si fëmijë të lindur prej tyre.<sup>33</sup> Birësuesi duhet të ketë një diferencë moshe të paktën 18 vjet me të birësuarin. Në qoftë se birësohet fëmija i bashkëshortit diferenca e moshës jo më pak se 15 vjet.<sup>34</sup>

Sipas legjislacionit të Maqedonisë, adoptues mund të jetë një person i aftë për të punuar, i cili ka cilësi personale për menaxhimin e suksesshëm të të drejtave prindërore dhe nuk është më i vjetër se 45 vjet. Adoptues mund të jetë personi i cili është 18 vjet më i vjetër se i adoptuari. Si përjashtim personi më i vjetër se 45 vjeç mund të jetë gjithashtu adoptues, por kufiri i moshës ndërmjet adoptuesit dhe të adoptuarit nuk mund të kalojë moshën 45 vjet. Bashkëshortët mund të paraqiten si prindër adoptues nëse njëri prej tyre nuk e kalon limitin e moshës së sipërme.<sup>35</sup>

### **3.1. Realizimi i adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve të Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë**

Sipas nenit 21 par. b), c), d) dhe e) të Konventës për të drejtat e fëmijës (1989), adoptimi/birësimi në një vend tjetër mund të shihet si një alternativë për të siguruar kujdes ndaj fëmijës, në qoftë se fëmija nuk mund të vendoset në një familje adoptuese, ose nuk mund të ketë përkuqjesjen në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme në vendin e tij të origjinës. Në rast të

<sup>33</sup> Nenin 3 par.2 i Ligjit për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptare të birësimit, Supra note 24.

<sup>34</sup> Neni 241 i Kodit të Familjes së Shqipërisë, Supra note 23.

<sup>35</sup> Neni 100-a i Ligjit për Familje i Maqedonisë, Supra 26.

adoptimit ndërkombëtar të fëmijës, ai fëmijë do të gëzojë mbrojtje dhe normë atë barasvlershme me ato që ekzistojnë në rastin e adoptimit në vendin e tij. Shtetet të cilat pranojnë/lejojnë adoptimin ndërkombëtar të fëmijës duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që sistemimi i fëmijës të mos kthehet në një përfitim material të pahijshëm/të pavend për personat e implikuar në të, si dhe mbështesin sipas rastit, objektivat lidhur me adoptimin, duke bërë rregullime ose marrëveshje dy palëshe ose shumë palëshe, dhe paraqiten në këtë kuadër të sigurojnë që sistemi i fëmijës në një vend tjetër të bëhet nga autoritetet ose organet kompetente.

Edhe konventa mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimet jashtë vendit (Konventa e Hagës) në nenin 1 të saj përveç tjerash parasheh që në rast të adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve duhet “të merren masat mbrojtëse për të siguruar që adoptimet jashtë vendit të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës dhe duke respektuar të drejtat e tij themelore, të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare”, dhe po ashtu “të krijohet një sistem bashkëpunimi midis Shteteve Kontraktuese, për të siguruar që këto masa të respektohen dhe në këtë mënyrë të parandalohet rrëmbimi, shitja ose trafikimi i fëmijëve”. Ndërsa në nenin 4 të po kësaj konvente, përveç tjerash, parashihet po ashtu se, një adoptim brenda sferës së Konventës kryhet vetëm në rast se autoritetet kompetente të shtetit të origjinës: kanë përcaktuar se fëmija mund të adaptohet; pasi kanë shqyrtuar të gjitha mundësitë për vendosjen e fëmijës brenda shtetit të origjinës, kanë vendosur se adoptimi jashtë vendit është në interesin më të lartë të fëmijës, etj.

Nga kjo që u tha më lart shihet se adoptimi duhet të bëhet vetëm atëherë kur interesi më i lartë i fëmijës së adoptuar është primar.

Në vijim janë paraqitur procedurat mbi adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni.

### **3.1.1. Procedura e adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve të Republikës së Kosovës**

Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i Kosovës në nenin 50 parasheh që, mbrojtja e të drejtave të fëmijës, e ndërmerr qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve. Gjithashtu, neni 7 i Ligjit për Familjen i Kosovës parasheh që për realizimin e të drejtave nga marrëdhëniet familjare nënës dhe fëmijës u sigurohet mbrojtje e posaçme me mjete të mirëqenies sociale, ndërsa fëmijëve pa kujdes prindëror u

sigurohet mbrojtja e posaçme përmes formave të mbrojtjes siç janë kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial dhe adoptimi.

Përveç akteve të sipërpërmendura, çështja e adoptimit pa prindër dhe kujdes prindëror rregullohet edhe me akte të tjera, siç është udhëzimi administrativ për rregullimin e procedurave të adoptimit për fëmijët pa kujdes prindëror, sipas të cilit udhëzim “fëmijë pa kujdes prindëror”, konsiderohet fëmija, prindërit e të cilit nuk janë gjallë, janë të panjohur, të zhdukur apo prindërit e të cilit për çfarëdo arsye, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nuk i kryejnë detyrat e tyre prindërore. Fëmijët e tillë mund të jenë potencialë për adoptim ndërkombëtar vetëm nëse janë shtjerrë të gjitha mundësitë për adoptim në Kosovë, ose fëmija që ka nevojë për trajtim shëndetësor jashtë vendit dhe/ose për çfarëdo arsye tjetër vlerësohet se adoptimi jashtë vendit është në interes më të mirë për fëmijën.<sup>36</sup>

Adoptues mund të jetë vetëm qytetari i Kosovës, mirëpo në raste të caktuara shtetasi/banori i huaj mund të jetë adoptues vetëm në rast se fëmija nuk mund të adoptohet ose birësohet në Kosovë dhe/ose ekzistojnë arsye të bazuara për veprimin e tillë, nëse fëmija ka nevoja të veçanta dhe ka nevojë për trajtim të specializuar shëndetësor jashtë vendit, e që nuk mund t’i ofrohet në Kosovë. Për adoptimin e fëmijës nga shteti i huaj nevojitet pëlqimi paraprak nga organi administrativ, kompetent për punët e politikës sociale.<sup>37</sup>

Në rast të fëmijës për adoptim, Qendra kompetente për Punë Sociale, duhet t’i drejtohet të gjitha qendrave për punë sociale në Kosovë, me letër qarkore dhe të presë përgjigjet e tyre deri në 30 ditë. Përgjigjet negative ose mospërgjigjja nga ndonjë qendër për punë sociale konsiderohet se për atë fëmijë janë shtjerrë të gjitha mundësitë për adoptim në Kosovë.

Qendra për punë sociale duhet të dërgojë kërkesën për panel dhe dosjen për adoptim ndërkombëtar të fëmijës pas ofrimit të dëshmimeve se janë shtjerrë të gjitha mundësitë për adoptim të fëmijës në Kosovë dhe pastaj duhet të evidentohet në regjistrin e fëmijëve potencialë për adoptim ndërkombëtar. Pas kësaj, paneli jep pëlqimin dhe iu bën propozimin familjeve në radhë të cilat janë të evidentuar në Regjistrin e fëmijëve potencialë për adoptimin ndërkombëtar. Fëmijët u propozohen familjeve ashtu siç janë në regjistër, pa dallim gjinie, race, kombi etj. Vlen

---

<sup>36</sup> Neni 3 par.1.6 dhe 1.10 i U.A për rregullimin e procedurave të adoptimit Nr 09/2014, Supra note 21

<sup>37</sup> Neni i 179 i Ligjit për Familjen i Kosovës. Supra note 2

të ceket, se prindërit potencialë për adoptim ndërkombëtar të fëmijëve të Kosovës nuk vijnë me kërkesa të veçanta për gjininë e fëmijës, përderisa kërkesat për adoptim vendor kryesisht kërkojnë adoptim të fëmijëve të gjinisë mashkullore.<sup>38</sup>

Aplikantët shtetas të huaj ose banorë në shtetin e huaj, të interesuar për adoptimin e fëmijës në Kosovë, duhet të vlerësohen sipas procedurave për adoptimin ndërkombëtar prej shërbimit/autoritetit qendror për adoptim, nga vendi në të cilin janë banorë rezidentë/të përhershëm, (neni 13 par.5 i U.A për adoptim Nr. 09/2014). Kjo vlen edhe për aplikantët kosovarë që jetojnë jashtë vendit, të cilët duhet të vlerësohen për përshtatshmërinë e tyre si prindër potencialë adoptues sipas procedurave për adoptim ndërkombëtar, nga autoriteti qendror për adoptim, i vendit në të cilin janë banorë të përkohshëm apo të përhershëm.<sup>39</sup>

Paneli shqyrton vetëm kërkesat e aplikantëve nga shtetet e huaja që janë të vlerësuara si të përshtatshme për adoptimin prej Shërbimit/Autoritetit Qendror për adoptim për vendin në të cilin janë banorë rezidentë. Pas vlerësimit profesional nga shërbimi autoriteti qendror, për përshtatshmërinë e familjes aplikuese për adoptim të fëmijës, dhe kompletimit të dokumentacionit të shtetit përkatës duhet të dërgohet dosja në misionet diplomatike apo Konsullore të Republikës së Kosovës, nga ana e autoritetit qendror ose Agjensionit të Akredituar për adoptim apo personalisht nga aplikuesi dosja konsiderohet e verifikuar atëherë kur këto misione konfirmojnë tërë vërtetësinë e dokumentacionit me shkresë të veçantë përmes formave të verifikimit që Misionet Diplommatike/Konsullore i aplikojnë.<sup>40</sup>

Familja aplikuese evidentohet në Regjistrin e familjeve potenciale për adoptim ndërkombëtar të fëmijës në Kosovë, pas pranimit të dosjes së verifikuar në Ministrinë e Punës e Mirëqenies Sociale (MPMS), përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, (neni 13 par.11 i U.A për adoptim Nr. 09/2014). Paneli brenda një viti do t'iu propozojë fëmijë potencialë për adoptim ndërkombëtar apo njofton me shkrim nëse ka fëmijë potencialë për adoptim ndërkombëtar përmes Autoritetit qendror të shtetit përkatës ose drejtpërdrejt komunikon familjen aplikuese për adoptim (neni 13 par.16 i U.A për adoptim Nr. 09/2014).

---

<sup>38</sup> Intervistë 2018 me zyrtarë në DPSF, MPMS e Kosovës, 16 korrik 2018, Supra note 12

<sup>39</sup> “Buletin informues për procedurat e adoptimit ndërkombëtar”, f.2, marrë më datë 16 korrik 2018 nga zyrtarë të DPSF, MPMS e Kosovës, 2018.

<sup>40</sup> Neni 13, par.16, par.7 dhe par.10 i U.A për rregullimin e procedurave të adoptimit të nr. 09/2014, Supra note 21

Prindërit potencialë adoptues, shtetas/banorë të shtetit të huaj, të cilët konfirmojnë pranimit për adoptim të fëmijës së propozuar nga Paneli, janë të obliguar të vinë në Kosovë dhe së bashku me Qendrën për Punë Sociale (QPS) kompetente, të iniciojnë procedurën për adoptim në Gjykatë, (neni 12 par.18 i U.A për adoptim Nr.09/2014). Pastaj Gjykata kërkesën ia dërgon QPS-së, ku paneli shqyrton kërkesat e aplikuesve të shtetasve të huaj që dëshirojnë të adaptojnë fëmijën në Kosovë (nëse janë respektuar të gjitha dispozitat ligjore, procedurale etj.), të cilët duhet të vlerësohen sipas procedurave për adoptim ndërkombëtar prej Shërbimit/Autoritetit Qendror nga vendi nga të cilët janë banorë aktualë apo të përhershëm.<sup>41</sup>

Prindërit potencialë adoptues me shtetësi të huaj, duhet të njoftojnë Departamentin Politik Social dhe Familjare (DPSF) para se të vinë në Kosovë, ndërsa DPSF-ja njofton departamentin përkatës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me qëllim të dhënies së leje qëndrimit për prindërit potencialë adoptues gjatë procesit të adoptimit të fëmijës në Kosovë.

Pas ardhjes dhe marrjes së Lejes së Qëndrimit në Kosovë, prindërit potencialë adoptues duhet të njoftojnë DPSF-në dhe QPS lidhur me adresën e saktë të vendqëndrimit të tyre në Kosovë gjatë procesit të adoptimit. Paneli mund t'ua marrë përparësinë në Regjistër familjeve potenciale për adoptim ndërkombëtar, të cilën për herë të dytë refuzojnë fëmijët e propozuar për adoptim nga Paneli.<sup>42</sup>

Nga kjo që u tha më lart shihet se edhe shtetasit kosovarë të cilët jetojnë jashtë Kosovës duhet të ndjekin procedurat e njëjta sikurse çdo shtetas tjetër ndërkombëtarë.

### **3.1.2. Procedura e adoptimit ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë**

Në Shqipëri rol të rëndësishëm në birësim ndërvendor (adoptim ndërkombëtar)<sup>43</sup> të fëmijëve luan Komiteti Shqiptar i Birësimeve (KSHB) i cili është Autoriteti Qendror i vetëm në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve e fushave vendore dhe ndërvendore. Shqipëria gjithashtu ka marrëveshje me disa agjencione ndërkombëtare, përmes të cilave ka realizuar adoptimet ndërkombëtare të

---

<sup>41</sup> Neni 9 par.1 i Udhëzimit Administrativ për përbërjen dhe funksionimin e panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe adoptim, Nr12/2012, Supra note 21

<sup>42</sup> Neni 13 par.19/21 i U. A për rregullimin e procedurave të adoptimit Nr09/2014 Supra note 21.

<sup>43</sup> Termin “birësim ndërvendore” në vend të “adoptim ndërkombëtar” të fëmijëve, e kemi përdorur aty ku flitet për adoptim ndërkombëtar të fëmijëve të Shqipërisë, pasi që ky term përdoret në legjislacionin e Shqipërisë.

fëmijëve. Si partnere të dobishëm ka: Amici Dei Bambini; SPAI; Bethany Christians Service; Adoption Worx Canada; Medicine du Monde; Comunita Sant'Egidio; Nightlight; Amarna etj.<sup>44</sup>

Në Shqipëri, për birësimin e fëmijëve, shtetasit e huaj nuk mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit Shqiptar të Birësimit. Kërkesa e tyre i paraqitet KSHB-së nëpërmjet autoriteteve publike kompetente ose organizmave private të parashikuar në ligj (agjencive ndërmjetësuese të vendit të tyre, por të cilat janë të njohura nga Komiteti). Shtetasit shqiptarë që kanë vendbanimin e tyre jashtë vendit dhe shtetasit e huaj rezidentë prej 2 vjetësh në Shqipëri, mund t'i drejtohen drejtpërdrejt KSHB-së. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe të dokumenteve përkatëse, Komiteti Shqiptar i Birësimit i dërgon Gjykatës studimin për personin që kërkon të birësojë dhe atë të miturin që mund të birësohet. Komiteti Shqiptar i Birësimit i dërgon gjykatës dhe pëlqimin me shkrim për këtë birësim dhe për birësimet ndërvendase, si dhe konfirmimin se i mituri nuk ka pasur mundësi të birësohet në Shqipëri për një afat prej 6 (muajsh) nga data e regjistrimit në listat e këtij Komiteti.<sup>45</sup>

### **3.1.3. Procedura e adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve të Republikës së Maqedonisë**

Për dallim nga Kosova dhe Shqipëria, ligji për familjen i Maqedonisë (neni 95 i LFM ) njeh dy lloje të adoptimit: adoptim të plotë – sipas të cilit krijohen marrëdhënie / raporte ashtu siç krijohen me lindje, dhe adoptimi jo i plotë – sipas të cilit krijohen marrëdhënie që ekzistojnë midis prindërve dhe fëmijëve. Se a krijohen marrëdhënie të adoptimit të plotë ose jo të plotë, varet nga vullneti i adoptuesit, prindërve të fëmijës së adoptuar (kur dihen), kujdestarit të fëmijës, e po ashtu edhe nga vetë fëmija, nëse fëmija është më i vjetër se dymbëdhjetë (12) vjet.

Adoptimi ndërkombëtar i fëmijëve të Maqedonisë, sikurse edhe në Kosovë, bëhet përmes Ministrisë për Punë dhe Politika Sociale. Përveç shtetasit të Maqedonisë adoptues mund të jetë edhe personi i cili është shtetas i huaj, por i cili i plotëson kushtet të cilat i kërkojnë ligjet në fuqi të Maqedonisë, si ekstrakte apo edhe informacione dhe prova të tjera për të siguruar të paktën kushte të njëjta ose më të mira të jetesës dhe zhvillimit të fëmijës, si dhe duhet siguruar që fëmija nuk ka mundur të adoptohet në Republikën e Maqedonisë, (neni 99 i LFM).

<sup>44</sup> Komiteti Shqiptar i Birësimeve <http://kshb.gov.al> (marrë më datë 18 prill 2019)

<sup>45</sup> Neni 252&253 i Kodit të Familjes së Shqipërisë, Supra note 23.



### 3.1.4. Dokumentet që duhet plotësuar për adoptim ndërkombëtar të fëmijëve

Në Kosovë për adoptim ndërkombëtar të fëmijës, aplikuesi duhet të dorëzojë në MPMS dokumentet si në vijim, në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të U.A për adoptim Nr. 09/2014

1. Kërkesë me shkrim nga prindi/ërit potencialë për adoptim;
2. Certifikatë e lindjes nga prindi/ërit potencialë (të dy bashkëshortët);
3. Certifikatë e lindjes për fëmijët, nëse prindërit potencialë për adoptim kanë fëmijë biologjikë ose të adoptuar;
4. Certifikatë e Martesës;
5. Dokumente të cilat shpjegojnë rrethanat ekonomike për prindin/ërit potencialë (duke i përfshirë faktet për pronën;
6. Dokument me të cilin vërtetohen të ardhurat nga punësimi apo nga vetëpunësimi dhe situata ekonomike për prindin/ërit potencialë;
7. Kopjet e letërnjoftimit dhe pasaportës;
8. Raporte mjekësore në të cilin dëshmohet aftësia e prindit/ërve potencialë se mund të adoptojnë fëmijë;
9. Certifikatë nga Gjykata Komunale dhe ajo e Lartë me të cilën dëshmohet se prindi/ërit potencialë nuk kanë qenë të dënuar për ndonjë krim dhe nuk janë nën hetime;
10. Certifikatë nga Gjykata Komunale me të cilën dëshmohet se prindi/ërve potencialë nuk iu është hequr e drejta prindërore dhe zotësia e veprimit, (shënim: apo barsvlera e përdorur në procedurën e adoptimit në vendin në të cilin janë banorë të përhershëm).<sup>46</sup>

Përveç këtyre dokumenteve, kërkohet edhe raport studimi dhe vlerësimi për përshtatshmërinë e prindërve potencialë për adoptim nga ana e Autoritetit Qendror për Adoptime nga vendi ku prindi/ërit potencialë adoptues jetojnë.<sup>47</sup> Dokumentacioni për Adoptim duhet të përgatitet në

---

<sup>46</sup> MPMS (pnn), Lista e dokumentacionit të kërkuar për aplikim të prindërve potencialë për adoptim ndërkombëtar të fëmijës në Kosovë, marrë nga zyrtarë të DPSF, MPMS e Kosovës, datë 16 korrik 2018

<sup>47</sup> Raporti duhet të rezultojë në vendim pozitiv. Vlerësimi duhet të përgatitet nga ana e punëtorit social, psikologut dhe pedagogut si dhe duhet të jetë në përputhje me Ligjin e Kosovës. Nëse mungon vlerësimi i psikologut apo pedagogut, atëherë duhet të sigurohet një raport i veçantë nga këta dy specialistë si dhe të ceket se prindi/ërit potencialë adoptues janë të përshtatshëm. Gjithashtu është e domosdoshme varësisht se si organizohet procesi në vendin e aplikuesve të përgatitet një dokument i veçantë në të cilin ceket vendimi i autoritetit qendror për adoptime së adoptimi ndërkombëtar është aprovuar dhe/ose informata për aprovim nga ana e autoritetit të zyrës kompetente

Agjencionet e Akredituara /Licencuara nga shtetet prej të cilëve vijnë aplikantët. Të gjitha dokumentet që përmban dosja e aplikantëve për adoptim ndërkombëtar duhet të jenë origjinale (jo më të vjetra se (6) muaj) të vulosura me vulë Apostile, të legalizuara nga organi kompetent për këtë shërbim apo të noterizuara, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të autorizuar në shtetin përkatës.<sup>48</sup>

Në Shqipëri, për dallim nga Kosova, me rastin e aplikimit për birësim kemi: dokumentet që duhet të plotësojnë aplikantët për birësimin e një fëmije si dhe dokumentet që duhet të plotësojnë aplikantët për birësimin e një fëmije me pëlqim.

Dokumentet që duhet të plotësojnë aplikantët për birësimin e një fëmije janë:

1. Kërkesë për motivin e birësimit drejtuar Komitetit (arsyet pse dëshiron të birësojë, seksi i fëmijës, mosha, fëmijë me nevoja të veçanta etj.);
2. Certifikatë lindjeje, familjare, martese e prindërit birësues;
3. Raport mjekësor dhe histori mjekësore familjare, epikrize-histori mjekësore lëshuar nga mjeku i familjes ose i njësisë ku banon, atje ku ka kartelën mjekësore, Analizat e SIDA-s dhe Hepatit B;
4. Dëshmi penaliteti nga prindërit birësues;
5. Vërtetimi i punësimit dhe të ardhurave;
6. Vërtetimi i pronës së banesës
7. Vërtetimi i gjendjes ekonomike dhe sociale, ku pasqyrojnë të ardhurat apo dispozitat e aplikuesit si: bankat, tatimtaksat, kontrata qiraje ose aktivitete të tjera;
8. Vërtetim nga organet e njësisë se qeverisjes vendore të vendbanimit për sjelljen dhe figurën morale, te lëshuara nga bashkia, komuna, njësia administrative;
9. Deklarate e gatishmërisë familjare dhe të miqve në mbështetje të aplikantit birësues, të lëshuara nga familjaret, miqtë, për gatishmërinë e tyre në mbështetje të familjes dhe integrimin e mirë të fëmijës në këtë familje;
10. Deklaratë para Noterit për gjendjen personale, familjare dhe sociale (arsimimi, kushtet e banimit, të ardhurat financiare);

---

duhet theksuar se fëmija do të jetë i autorizuar të hyjë dhe të ketë banim të përhershëm në atë shtet ose do t'i jepet shtetësia menjëherë pas adoptimit. MPMS (pnn), Lista e dokumentacionit të kërkuar për adoptim. Supra note 47.

<sup>48</sup> MPMS (pnn), Lista e dokumentacionit të kërkuar për adoptim. Supra note 47.

11. Fotografi për aplikantin birësues në këmbë (përmasat 10 – 15 cm).<sup>49</sup>

Përveç dokumenteve të kërkuara me sipër, aplikantët për birësimin e një fëmijë me pëlqim duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente:

1. Certifikatë lindjeje për secilin prind biologjik;
2. Certifikatë lindjeje për fëmijën;
3. Certifikatë familjare e familjes biologjike;
4. Certifikatë martese e prindërve biologjikë;
5. Vendim i Gjykatës për dhënien e pëlqimit për birësim nga prindërit biologjikë;
6. Epikrize mbi historinë mjekësore biologjike dhe të të miturit;
7. Analizë e Sidës, hepatit për prindërit biologjikë dhe të miturin;
8. Dëshmi penaliteti për prindërit biologjikë;
9. Fotografi e fëmijës.<sup>50</sup>

Kërkesa dhe dokumentet që e shoqërojnë duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, dy kopje origjinale ose të noterizuara, sipas ligjit të vendit ku jeton birësuesi, (neni 252 i LFSH-së). Për birësimet ndërvendase, që do të shpallen në Shqipëri, Këshilli drejtues i Komitetit vërteton: vlefshmërinë e dokumentacionit të aplikantëve birësues miratimin nga organi kompetent i huaj, i përshtatshmërisë së aplikantëve birësues; përputhjen e parimeve të legjislacionit shqiptar me atë të shtetit të birësuesit, bashkëpunimin me autoritet e vendit pritës, që birësimi të mos dështojë dhe fëmija të autorizohet të hyjë për të banuar përgjithmonë në shtetin pritës. Komiteti i dërgon gjykatës vërtetimin se fëmija nuk ka pasur mundësi të birësohet në Shqipëri për një afat prej gjashtë (6) muajsh, si dhe vërtetimin që fëmija do të gëzojë në vendin e aplikuesve për birësim të njëjtat të drejta si në Shqipëri.<sup>51</sup>

Si në Kosovë dhe në Shqipëri, po ashtu edhe në Maqedoni, kërkohet për t'u plotësuar dokumentet e nevojshme për adoptim ndërkombëtar të fëmijëve. Për këtë qëllim, në nenin 9 dhe 10 të “Rregullores për mënyrën e mbrojtjes së shënimeve për personat e adoptuar dhe

<sup>49</sup> Këshilli shqiptar për birësime, i disponueshëm në: [http://kshb.gov.al/?page\\_id=230\(marre](http://kshb.gov.al/?page_id=230(marre) më 17 korrik 2018).

<sup>50</sup> Ibid.

<sup>51</sup> Neni 27-28 i Ligjit për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit nr. 9695, 19.3.2007, (ndryshuar me ligjin 10358, dt.16.12.2010, dhe dt. 5.12.2015). Supra note 24.

përcaktimin e dokumenteve për adoptim”,<sup>52</sup> personi i cili dëshiron të adoptojë një fëmijë në kërkesën për adoptim ndërkombëtar të fëmijës duhet të paraqesë dokumentet e nevojshme si në vijim:

1. Certifikatë e lindjes, nga libri amëz i të lindurve;
2. Certifikatë e shtetësisë e prindërit adoptues;
3. Certifikatë gjyqësore e mosdënimit;
4. Vërtetim nga gjykata se nuk i është hequr zotësia e veprimit të së drejtës prindërore;
5. Certifikatë nga gjykata se nuk është privuar nga aftësia e biznesit/afariste;
6. Certifikatë mjekësore e aplikuesit, se është i aftë psiko-fizikisht për të qenë prind;
7. Vërtetim mbi shumën e të ardhurave mujore;
8. Certifikatë nga Zyra e të hyrave publike lidhur me gjendjen materiale;
9. Dëshmi e pronësisë së banesës, shtëpisë apo pushimores;
10. Dëshmi për shkollimin e përfunduar;
11. Certifikatë nga librat amëz për të kurorëzuarit, kur aplikues paraqiten të dy bashkëshortët;
12. Ekstrakt i vendit të prejardhjes së adoptuesit në lidhje me adoptimin, informacione dhe prova të tjera dhe dëshmi për të siguruar kushte të barabarta ose më të mira të jetesës dhe zhvillimit të fëmijës;
13. Raport nga shërbimi social për aftësitë e përshtatshmërisë dhe arsyet e adoptimit, prejardhjen e tyre, historinë familjare dhe mjekësore, mjedisin shoqëror, arsyet për adoptim, aftësinë për realizimin e adoptimit ndërkombëtar, si dhe karakteristikat e fëmijëve për të cilat do të ishin në gjendje të përkujdeseshin.

Dokumentet nuk duhet të jenë më të vjetra se një (1) vit, duhet të dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuara nga noteri, si dhe të jenë me përkthim të certifikuar në gjuhën maqedonase. Komisioni për themelimin e adoptimit, pas shqyrtimit të dokumenteve, një kopje të dokumenteve ia dërgon QPS-së, të vendbanimit të aplikuesit. QPS-ja brenda katër (4) muajve të ardhshëm, zhvillon dhe monitoron procedurë për prindërit e ardhshëm adoptues, për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre për adoptim. Pas kësaj periudhe QPS-ja brenda 10 ditëve i paraqet Komisionit për themelimin e adoptimit Propozimin për regjistrim në regjistrin e adoptuesve të

---

<sup>52</sup> Rregullore për mënyrën e mbrojtjes së shënimeve për personat e adoptuar dhe përcaktimin e dokumenteve për adoptim, Nr. 10 dt.28.02.2011, marrë me datë 03.07.2018 e disponueshme në:  
[https://www.mtps.gov.mk/WBStorage/Files/pravilnik\\_evidencija\\_posvoeni.pdf](https://www.mtps.gov.mk/WBStorage/Files/pravilnik_evidencija_posvoeni.pdf)

mundshëm. Me rastin e regjistrimit të prindërve të mundshëm adoptues Komisioni do të informojë prindërit adoptues për Regjistrin. Në pajtim me Ligjin për Familjen të RM, zgjedhja e adoptuesit për fëmijë të caktuar bëhet në mënyrë elektronike, në pajtim me Rregulloren për kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes elektronike të adoptuesve Nr.10-2831/3. Disa nga kriteret për përzgjedhje të prindit adoptues sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje janë: gjendja shëndetësore, statusi psiko-social, kushtet e banimit, shkalla e arsimit, statusi martesor, shtetësia etj. Numri maksimal i pikëve që mund të arrihet duke përbushur të gjitha kriteret është 100.

Vlen të ceket, se një rregullore të tillë nuk kam hasur në legjislacionin e Shqipërisë dhe Kosovës.

### **3.1.5. Mendimi dhe pëlqimi i fëmijës që adoptohet si dhe mosha e adoptuesit dhe të adoptuarit**

Mendimi dhe pëlqimi i fëmijës potencial për adoptim është një ndër elementet kyçe për adoptim, posaçërisht për adoptim ndërkombëtar të fëmijës.

Në Kosovë, mendimi i fëmijës merret parasysh në çdo fazë të procedurës, dhe me rastin e ofrimit të shërbimit deri në masën që vlerësohet si i dobishëm dhe në interesat e fëmijës. Ky pëlqim kërkohet vetëm mbi moshën katërmëdhjetë (14) vjeç, ndërsa kur fëmija është më i ri se katërmëdhjetë (14) vjet, pëlqimi mund të jepet vetëm nga përfaqësuesi i tij ligjor, përkatësisht kujdestari i të adoptuarit.<sup>53</sup> Për adoptimin e fëmijës duhet të merret edhe vendimi i fëmijës mbi moshën 10 vjeçare, i cili është edhe pjesëmarrës në procedurë.<sup>54</sup>

Dallimi në moshë në mes të adaptuarit dhe adoptuesit nuk duhet të jetë më e madhe se mosha pesëdhjetë (50) vjeç. Kur mosha e çiftit bashkëshortorë është mbi moshën pesëdhjetë (50) vjeçare Qendra për Punë Sociale duhet të bëjë vlerësimin e përshtatshmërisë duke e llogaritur moshën e çiftit bashkëshortor dhe e përcakton moshën e fëmijës që mund ta adoptojë, ndërsa në rastet kur çifti ka dallim në moshë, atëherë përcakton mosha e fëmijës së mundshëm për adoptim në raport me moshën më të vogël të njërit nga bashkëshortët.<sup>55</sup>

<sup>53</sup> Neni 168 par.1-3 i ligjit për familjen i Kosovës, Nr. 2004/32, supra note 2

<sup>54</sup> Neni 6 par.9 i U.A për rregullimin procedurave të adoptimit Nr. 09/2014. Supra note 21.

<sup>55</sup> Neni 9 par.1-3 i U.A për rregullimin e procedurave të adoptimit Nr 09/24, Supra note 21.

Prindi i ardhshëm adoptues duhet t'i ketë arritur moshën 21 vjeçare. Nëse adoptimi bëhet nga bashkëshortët, njëri nga bashkëshortët duhet të ketë arritur moshën 25 vjeç dhe bashkëshorti tjetër duhet të ketë arritur moshën 21 vjeç.<sup>56</sup>

Për adoptimin e fëmijës kërkohet pëlqimi i prindërve dhe ky pëlqim nuk mund të jepet para se t'i ketë mbushur fëmija tetë 8 (javë). Gjithashtu nuk kërkohet pëlqim nga bashkëshorti i cili me vendim të gjykatës ka humbur kujdestarinë ose e ka humbur aftësinë për të vepruar, ose vendbanimi i të cilit nuk dihet për më shumë se një vit. Pëlqimi duhet t'i deklarohet gjykatës dhe bëhet i plotfuqishëm në kohën e dorëzimit. Pëlqimi nuk mund të bëhet me kusht dhe me përcaktimin e kohës, e as nuk mund të bëhet nga përfaqësuesi. Ai është i përvokueshëm për aq sa pëlqimi nuk është dhënë në lajthinë apo me shtrëngim ose mashtrim. Pëlqimi i prindit do të bëhet i joplotfuqishëm nëse fëmija nuk adoptohet brenda tri viteve nga data kur pëlqimi bëhet efektiv, (neni 169&172 i Ligji për Familjen i Kosovës 2004/32).

Në Shqipëri, kur fëmija ka mbushur moshën 10 vjeç, birësimi kryhet vetëm kur Komiteti ka marrë mendimin e tij dhe pasi siguron se: a) fëmija është i këshilluar dhe informuar për pasojat e birësimit dhe të dhënies së mendimit të tij për birësimin; b) janë marrë parasysh mendimet dhe dëshirat e fëmijës, kur ato janë në interes të tij; c) mendimi i fëmijës është në mënyrë të vullnetshme dhe është dokumentuar apo evidentuar me shkrim, sipas formës së përcaktuar nga Komiteti; C) mendimi nuk është dhënë kundrejt pagesës apo çdo lloj kompensimi tjetër.

Kur fëmija ka mbushur moshën 12 vjeç, për birësim kërkohet pëlqimi i tij, në përputhje me kërkesat sipas pikës a), b), c), dhe c) më sipër.<sup>57</sup>

Kur i birësuar ka mbushur moshën dhjetë (10) vjeç merret mendimi i tij dhe në moshën dymbëdhjetë (12) vjeç kërkohet pëlqimi i tij. Për birësimin e të miturit kërkohet pëlqimi i të dy prindërve të tij. Në qoftë se njëri nga të dy prindërit ka vdekur, nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij, ose i është hequr përgjegjësia prindërore, pëlqimi i prindit tjetër është i mjaftueshëm. Kur fëmijës i kanë vdekur të dy prindërit, kur atyre u është hequr zotësia për të

---

<sup>56</sup> Neni i 176 par.1-2 te ligji për familjen i Kosovës, Nr,2004/32. Supra note 2

<sup>57</sup> Neni 15 i Ligjit për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit nr .9695,19.3.2007, (ndryshuar me ligjin 10 358, dt.16.12.2010, dhe 132/2005, dt.5.12.2015). Supra note 24.

vepruar ose janë të panjohur, gjykata vendos nëse fëmija duhet të birësohet. Kur birësuesi është i martuar, duhet të merret pëlqimi nga bashkëshortit të tij.<sup>58</sup>

Edhe në Maqedoni, sikurse në Kosovë dhe Shqipëria për themelimit e adoptimit kërkohet mendimi / pëlqimi i fëmijës që do të adoptohet. Sipas nenit 103 të LFM, pëlqimi i fëmijës kërkohet, nëse fëmija është më i vjetër se dymbëdhjetë (12) vjet. Në rast se prindi është i mituri, përveç pëlqimit të tij, merret pëlqimi i përfaqësuesit ligjor.

Nuk kërkohet pëlqimi as i të adoptuarit i cili deri në adoptim ka jetuar me familjen e adoptuesit para mbushjes së moshës (12) vjeçare. Përveç kësaj, kërkohet edhe pëlqimi i të dy prindërve të të adoptuarit, apo kujdestarit të tij.

Përveç kërkesës për pëlqimin të prindërve dhe të adoptuarit, dhe nga vetë adoptuesi, ka raste kur adoptimi bëhet edhe pa pëlqim të këtyre të cekur më lart. Këto raste janë si më poshtë:

\* Nuk kërkohet pëlqim i prindit të cilit i është hequr zotësia juridike e veprimit ose i është hequr (është privuar nga) e drejta prindërore apo prindi të cilit më shumë se një vit nuk i dihet vendbanimit (vendqëndrimi).

\* Nuk kërkohet pëlqimi as nga prindi i fëmijës së vendosur në institucionin ose familje tjetër që nuk ka treguar/shpreh interes për fëmijën për më shumë se gjashtë (6) muaj nga koha/afati që ka qenë i detyruar (do të duhej) ta merrte fëmijën.

\* Nuk kërkohet pëlqimi i personit, të përcaktuar nga nëna e një fëmije të lindur jashtë martese, si babai i atij fëmije, i cili brenda (3) muajve pas lindjes së fëmijës, nuk ka ngritur procedurë mbi njohjen apo vërtetimin e atësisë.<sup>59</sup>

Askush nuk mund të adoptohet nga më shumë se një person, përveç kur bashkëshortët paraqiten si prindër adoptues (neni 98 i LFM).

---

<sup>58</sup> Neni 246 i Kodit të Familjes të Shqipërisë. Supra note 23.

<sup>59</sup> Neni 103 par.3,4 dhe 6 i Ligjit për Familje i Maqedonisë. Supra note 26.

### 3.1.6. Periudha provuese, paraadoptuese

Për themelimin e adoptimit të fëmijëve, ligjvënësi ka paraparë edhe periudhën paradoptuese, periudhë e cila është mjaft e ndjeshme, posaçërisht kur kemi parasysh adoptimin e fëmijës nga jashtë vendit, ku fëmija do të ballafaqohet me një ambient të ri, me kulturë, gjuhë, (kur është më i rritur) dhe zakone të ndryshme nga ato vendore.

Në Kosovë, periudha provuese paraadoptuese caktohet nga Gjykata. Pas caktimit të kësaj periudhe nga Gjykata, QPS duhet të realizojë së paku tri kontaktime në mes të fëmijës dhe familjes / prindërve potencialë për adoptim. Periudha provuese mbikëqyret dhe vlerësohet vazhdimisht nga Organi i Kujdestarisë, i cili i siguron gjykatës raport, sipas nevojës. Organi i kujdestarisë gjatë kësaj periudhe viziton fëmijën së paku një herë në muaj, në mënyrë që të bindet për mirëqenien e fëmijës dhe lidhjen emocionale të krijuar mes fëmijës së adoptuar dhe prindërve adoptues. Nëse gjatë periudhës paraadoptuese Organi i Kujdestarisë vlerëson se nuk janë përmbushur interesat e fëmijës, duhet të njoftojë me shkrim Gjykatën. Në rast të lëndimit të rënd apo vdekjes së fëmijës, si pasojë e lëndimit apo nga ndonjë shkaktar tjetër gjatë qëndrimit të fëmijës në periudhën provuese, familja duhet të njoftojë Organin e Kujdestarisë së QPS-së, i cili pastaj përmes drejtorisë komunale duhet të iniciojë zhvillimin e procedurave hetimore për rrethanat, tek organet kompetente të hetuesisë.<sup>60</sup> Gjykata është e obliguar që fillimisht përmes vendimit të aplikojë periudhën paraadoptuese, që mund të zgjasë deri në tre (3) muaj.<sup>61</sup>

Në Shqipëri me dhënien e pëlqimit për çdo birësim, me propozimin e sekretariatit ekzekutiv këshilli drejtues përcakton periudhën e provës, e cila nuk mund të jetë më shumë se tre (3) muaj. Në përfundim të periudhës së provës, sekretariati ekzekutiv përgatit raportin për përshtatshmërinë e aplikantëve birësues e kanë pasur fëmijën në kujdestari familjare për një periudhë më të gjatë se tre (3) muaj dhe vërtetohet se kjo marrëdhënie ka qenë afektive, periudha e provës nuk është e domosdoshme.<sup>62</sup>

Në rast se personi ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tij në një vend tjetër, pëlqimi për birësim i jepet para agjentit diplomatik ose konsullor pranë ambasadës ose konsullatës shqiptare. Pëlqimi

<sup>60</sup> Neni 15 par.1-9 i U.A për rregullimin e procedurave të adoptimit Nr09/2014, Supra note 21.

<sup>61</sup> “Buletin Informues për Procedura e Adoptimit Ndërkombëtar“, f.2, marrë me datë më 16 korrik 2018 nga zyrtarë të DPSF, MPMS e Kosovës, 2018

<sup>62</sup> Neni 25 i Ligjit për procedurat e birësimit e komitetin shqiptar të birësimit nr. 9695, 19.03.2007, (ndryshuar me ligjin 10 358, dt. 16.12.2010, dhe 132/2015, dt 05.12.2015 ) Supra note 24.



për birësim mund të tërhiqet nga prindërit biologjikë, brenda 3 muajve nga çasti i dhënies së tij. Kjo periudhë shërben si periudhë prove për marrëdhëniet midis birësuesve dhe të birësuarit. Prindërit mund të tërheqin pëlqimin e tyre dhe pas kalimit të afatit tremujor, deri në çastit e marrjes së vendimit nga gjykata kompetente. Trashëgimtarët e birësuesit mund të paraqesin në gjykatë pretendimin për të kundërshtuar birësimin. Nëse birësimi pranohet nga gjykata, ai sjell efekte që nga çasti i dhënies së pëlqimit nga birësuesi.<sup>63</sup> Në Maqedoni periudha paraadoptuese është periudha Komisioni përcjellë gjendjen nëse fëmija ka arritur përshtatshmërinë e duhur me familjen adoptuese. Adoptimi nuk do të themelohet deri sa Komisioni nuk vërteton se adoptuesi është në gjendje të kujdeset për fëmijën për një periudhë kohore, për të paktën gjashtë (6) muaj, por jo më shumë se një (1) vit (neni 104-b LFM). Për adoptim ndërkombëtar të fëmijës, është e nevojshme që adoptuesi gjysmën e periudhës adaptive ta kalojë në Republikën e Maqedonisë (d.m.th një muaj deri në një muaj e gjysmë), përjashtimisht, nëse adoptohet fëmija i moshës tre (3) vjeçare, kohëzgjatja e periudhës adoptuese mund të zgjatet, por jo më shumë se 6 muaj.

Komisioni duhet të ketë kujdes të veçantë dhe të mbajë kontakte të vazhdueshme me adoptuesit për të kontrolluar se a është realizuar interesi më i lartë i fëmijës dhe adoptuesi a arrin të ushtrojnë të drejtat e tij tanimë prindërore, sipas nevojave dhe kërkesave të fëmijës. Edhe konventa Evropiane për adoptim të fëmijëve, e vitit 2008 u lë hapësirë shteteve kontraktuese që në ligjet e tyre nacionale të përcaktojnë periudhën e adoptimit në familjen e adoptuesit, për çdo herë duke e përcaktuar në pajtueshmëri me interesin më të lartë të fëmijës.<sup>64</sup>

### **3.1.7. Themelimi i adoptimit, mbiemri dhe periudha pas-adoptuese**

Me themelimin e adoptimit, prindërit adoptues konsiderohen prindër të të adoptuarit me të gjitha përgjithësitë sikur të ishin prindër biologjikë. Kështu pas adoptimit nuk lejohet vërtetimi i amësisë ose atësisë së fëmijës të adoptuar.

Në Kosovë themelimi i adoptimit të fëmijës pa kujdes prindëror bëhet në Gjykatë, dhe nevojitet prania e: prindërve adoptues, kujdestarit ligjor të fëmijës dhe të adoptuarit nëse është më i vjetër

---

<sup>63</sup> Neni 247-249 i Kodit të Familjes të Shqipërisë. Supra note 23.

<sup>64</sup> Arta Selmani, Çështje të adoptimit në Maqedoni-RSHSL, Konferenca 2008, f.11 (e disponueshme në <http://ajls.org/doc/ASelmani-Adoptimi-AJLS-2008.pdf>)

se një (1) vit. Deklarata e pëlqimit të tyre shënohet në procesverbal, ndërsa për fëmijën në paaftësi për të vepruar, pëlqimi mund të jepet vetëm nga kujdestari i tij ligjor. Pas themelimit të adoptimit, brenda 24 orëve QPS-ja duhet të njoftojë DPSF-në për themelimin e adoptimit. Në rast se Gjykata bie në vendim negative për adoptimin, atëherë Organi i Kujdestarisë e merr menjëherë fëmijën në mbrojtje.<sup>65</sup> Me rastin e themelit të adoptimit ndërkombëtar nga Gjykata, qendra për punë sociale kompetente duhet që të sigurohet se fëmija do të udhëtojë së bashku me familjen adoptuese në shtetin e pranimi (neni 162 i LFK-së).

Në Procesverbalin e Gjykatës gjatë themelimit të adoptimit përshkruhen të gjitha të dhënat për të gjitha veprimet e marra gjatë adoptimit: mbiemri i të adoptuarit sipas mbiemrit të palës adoptuese, ndryshimi i emrit të parë, respektivisht shtimi i emrit të parë etj. (neni 187, par.2 dhe 3 i LFK-së). Gjykata kompetente ia dërgon menjëherë procesverbalin për themelimin e adoptimit organit kompetent për regjistrimin në librin amzë të të lindurve, palës dhe Organit të Kujdestarisë. Pala adoptuese regjistrohet si prind i të adoptuarit, kështu fëmija e merr mbiemrin e personit adoptues sikur të ishte mbiemri i tij.<sup>66</sup>

Nëse çifti i martuar adopton fëmijë ose nëse njëri nga bashkëshortët e adopton fëmijën e bashkëshortit tjetër dhe bashkëshortët nuk kanë mbiemër të përbashkët të martesës, ata duhet të përcaktojnë mbiemrin e lindjes së fëmijës duke bërë deklaratë në Gjykatë para se të shqiptohet adoptimi (neni 193 par.2 i LFK-së).

Gjykata mund gjatë shqiptimit të adoptimit të ndryshojë emrin e parë të fëmijës ose të shtojë një apo më shumë emra të parë nëse kjo është në interesat e mirërritjes së fëmijës; ose familja e re, me pëlqimin e fëmijës vendose t'i japë mbiemrin e ri para ose pas mbiemrit të mëparshëm, nëse kjo është në interesat e mirërritjes së fëmijës (neni 193 par.3 i LFK-së).

Kur i adoptuari është më i vjetër se dhjetë (10) vjet, pëlqimi i tij kërkohet për ndryshimin e mbiemrit dhe çdo ndryshim të emrit (neni 193 par.4 i LFK-së). Sipas nenit 181 të po të njëjtit ligj, në procedurën e adoptimit përjashtohet publiku.

Në Shqipëri kërkesa për birësim nga një shtetas i huaj ose nga një shqiptar që banon jashtë shtetit, paraqitet në gjykatën e juridiksionit e së cilët ndodhet vendbanimi i të miturit. Kërkesa

---

<sup>65</sup> Neni 16 par 1-2 Neni 17 par.2&4 i U.A për rregullimin e procedurave të adoptimit Nr. 09/2014, Supra note 21.

<sup>66</sup> Neni 188 i Ligjit për Familjen i Kosovës. Supra note 2.

për birësim eë miturit shqiptar që banon jashtë shtetit paraqitet në Gjykatën e rrethit gjyqësore Tiranë (neni 254 i KFSH-së). KSHB i dërgon gjykatës studimin për personin që kërkon të birësojë dhe atë për të miturin që mund të birësohet, si dhe pëlqimin me shkrim për birësim ndërvendas si dhe konfirmimin se i mituri nuk ka pasur mundësi të birësohet në Shqipëri në një afat prej gjashtë (6) muajsh.<sup>67</sup>

Sa i përket të dhënave për mbiemrin sipas legjislacionit të Shqipërisë, i birësuarit merr mbiemrin e birësuesit në rast të birësimit nga të dy bashkëshortët, mbiemrin e përbashkët të të dyve; në qoftë se ata kanë mbiemra të ndryshëm vendosin me marrëveshje se cilin mbiemër do të mbajë i birësuarit; në rast mosmarrëveshje, fëmija merr mbiemrin e të atit. Me kërkesë të birësuesit ose të birësuesve, gjykata mund të ndryshojë emrin e të birësuarit. I birësuarit merr për emër nënë dhe atij të birësuesit ose birësuesve të tij.<sup>68</sup>

Në Maqedoni themelimi i adoptimit zhvillohet me procedurë ligjore. Përparësi gjatë adoptimit kanë qytetarët e Maqedonisë, ndërsa shtetasit e huaj, para se të adoptojnë fëmijë nga Maqedonia duhet të bëjnë kërkesë në shtetin e tyre amë. Pastaj përmes rrugëve zyrtare kërkesa dorëzohet deri te komisioni kompetent në kuadër të ministrisë për punë dhe politike sociale.<sup>69</sup>

Themelimi i adoptimit bëhet me nxjerrjen e Aktvendimit. Për të gjithë procesin e adoptimit mbahet procesverbal, ku do të jenë të shënuara informacionet mbi: llojin e adoptimit, emrin personal të të adoptuarit, vendin e lindjes së fëmijës, të drejtat e tij trashëgimore (në rast se adoptimi është jo i plotë). Procesverbali nënshkruhet nga zyrtari i QPS-së që përfaqëson fëmijën, prindërit e fëmijës, prindërit adoptues dhe Kryetari i Komisionit.<sup>70</sup>

Gjatë themelimit të adoptimit, prezent duhet të jenë adoptuesi/sit, prindi/ërit apo kujdestari/rët ligjore të të adoptuarit, dhe i adoptuari, nëse është më i vjetër se dymbëdhjetë (12) vjet, përjashtimisht, nëse ka jetuar në familjen e adoptuesit para mbushjes së moshës dymbëdhjetë (12) vjeçare. Në raste të justifikuara nuk është e nevojshme prania e bashkëshortit të adoptuesit, i

---

<sup>67</sup> Neni 253 i Kodit të Familjes të Shqipërisë. Supra note 23.

<sup>68</sup> Ibid, neni 260

<sup>69</sup> <http://www.botasot.info/maqedonia/554715/te-huajt-vijne-per-per-femije-ne-maqedoni/marre> me datë 1 gusht 2008

<sup>70</sup> Neni 110 i Ligjit për Familjen i Maqedonisë. Supra note 26.

cili nuk paraqitet si adoptues, nëse pëlqimi i tij për adoptim e ka dhënë në Qendrën për Punë Sociale, në procesverbalin ku janë shënuar adoptuesi dhe të adoptuarit.<sup>71</sup>

Pas themelimit të adoptimit në regjistrin amzë të të lindurve, si prindër të fëmijës regjistrohen prindërit adoptues, ndërsa vendi i lindjes së fëmijës regjistrohet vendi për të cilin janë dakorduar ndërmjet vete prindërit adoptues dhe Komisioni, (neni 11 i LFM-së). Zyrtari për regjistrime në librin amzë duhet të bëjë regjistrim e fëmijës, dhe t'u jap prindërve adoptues një certifikatë lindjeje (neni 11 i LFM-së). Në librin e regjistrimit do të shënohen të dhënat për personat e adoptuar.<sup>72</sup> Aprovimi i adoptimit bëhet pa pranin e publikut (neni 105 i LFM-së).

Shumë shtete të botës (Etiopia, Togo, Kina, Tanzania etj.) të cilat lejojnë adoptim, kërkojnë që prindërit adoptues të ofrojnë informacione lidhur me progresin dhe mirëqenien e fëmijës pas bashkimit të tij me familjen e re adoptuese, nëpërmjet dorëzimit të raporteve pas adoptimit.

Kërkesat janë specifike dhe ndryshojnë nga vendi në vend, dhe ndonjëherë janë mjaft të detajuara dhe mund të zgjasin derisa fëmija i adoptuar të mbush moshën 18 vjeç (ose dhe më shumë, në raste të rralla).<sup>73</sup> Vlen të ceket se pas themelimit të adoptimit nga Gjykata themelore e Kosovës dhe udhëtimit të fëmijës me prindërit adoptues në shtetin pritës, Autoriteti qendror i adoptimeve të shtetit pritës, duhet të raportojë në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në departamentin e politikave sociale dhe familjare) për dy vitet e para pas adoptimit të realizuar, lidhur me progresin për zhvillimit psiko-fizik e social të fëmijës dhe lidhjes që po krijohet në mes fëmijës së adoptuar dhe prindërve adoptues.<sup>74</sup>

---

<sup>71</sup> Neni 105 i Ligjit për Familjen i Maqedonisë. Supra note 26.

<sup>72</sup> Për të adoptuarin: emri&mbiemri para adoptimit dhe pas adoptimit; për prindin adoptues, përkatësisht prindërit adoptues: emri&mbiemri, vendbanimi, adresa e vendbanimit, bashkësia dhe shteti; për prindërit e adoptuar: emri&mbiemri, banesa, vendbanimi, adresa e vendbanimit, bashkia dhe shteti; për adoptimin: dita, muaji dhe viti i adoptimit; numri i vendimit për adoptim dhe QPS; lloji i adoptimit dhe të drejtave e trashëgimisë ndaj adoptuesit nëse adoptimi nuk është i plotë. Këto të dhëna do të jenë në pajtim me Nenin 5 të Rregullores për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për adoptuesit e mundshëm. Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për adoptues të mundshëm. Supra note 27.

<sup>73</sup> Të dhënat e disponueshme në: <https://travel.state.gov/content/travel/en/intercountry-Adoption/post-adoption-reporting.html>, marrë me datë 15 shtator 2018.

<sup>74</sup> “Buletin Informues për Procedurat e Adoptimit Ndërkombëtar”, f.2, marrë me datë 16 korrik 2018 nga zyrtarë të DPSF, MPMS e Kosovës, 2018

### 3.1.8. E drejta në martesë dhe trashëgimi e të adoptuarit

Në Kosovë – që një fëmijë i adoptuar do të jetë i barabartë me një fëmijë biologjik sa i përket të drejtës së martesës dhe trashëgimisë, e sqaron edhe legjislacioni në fuqi i Kosovës. Kështu adoptimi është pengesë martesore dhe gjinia e themeluar me adoptim është pengesë për martesë sikur gjinia e gjakut, neni (neni 22 par. 1-2 i LFK-së).<sup>75</sup>

Sa i përket trashëgimisë, të adoptuarit kanë të drejta të barabarta me fëmijët e lindur nga prindër biologjikë, kështu sipas ligjit për trashëgiminë “fëmijët e lindur në martesë, jashtë martese, kur atësia është njohur rregullisht ose është vërtetuar me vendim të gjykatës apo organit kompetent si dhe atë adoptuar si dhe pasardhësit e tyre kanë të drejta të barabarta n trashëgimi”. I adoptuari nuk trashëgon në familjen e origjinës së tij e as anëtarët e familjes nuk e trashëgojnë të adoptuarin.<sup>76</sup>

Edhe në Shqipëri ndalohet martesë midis birësuesit dhe të birësuarit dhe pasardhësve të tyre, të birësuarit dhe bashkëshortit të birësuesit midis birësuesit e bashkëshortit të të birësuarit, midis të birësuarve, si dhe midis të birësuarit dhe fëmijëve të birësuesit.<sup>77</sup>

Nisur nga parimi i heteroseksualitetit që e njeh e drejta familjare lidhur me martesën, atëherë nënvizojmë se ndalohet birësimi prej një çifti homoseksual.<sup>78</sup> Edhe pse Kushtetuta e Kosovës nuk ndalon martesat<sup>79</sup> e një çifti homoseksual, sipas të dhënave nga MPMS-ja, deri më tani nuk ka pasur asnjë kërkesë për adoptim nga persona homoseksual.

Në Maqedoni me adoptimin e plotë midis adoptuesit dhe familjes së tij dhe të adoptuarit dhe pasardhësit e tij, krijohen të drejtat dhe detyrime, njëjtë si ato të të afërmeve të gjinisë së gjakut. Pra, me këtë lloj adoptimi pushojnë të drejtat dhe detyrimet në mes të fëmijës së adoptuar dhe familjes së tij të mëparshme. Nëse si adoptues është njëri nga prindërit e fëmijës së adoptuar,

---

<sup>75</sup> Neni 22 i Ligjit për trashëgimi i Kosovës 2004/26, i disponueshëm në: <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2407>

<sup>76</sup> Hamdi Podgorica, E Drejta Trashëgimore, Prishtinë, 2010, f.17

<sup>77</sup> Neni 14 Kodit të Familjes të Shqipërisë. Supra note 23

<sup>78</sup> Arta Mandro, E Drejta Familjare, Tiranë, 2009, f.471

<sup>79</sup> “Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes. Mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të krijojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit...”. Neni 14 par.1 dhe 2 i Ligjit për Familjen i Kosovës, Supra note 2.

atëherë adoptimi nuk ndikon në marrëdhëniet ndërmjet fëmijës së adoptuar dhe atij prindi, si dhe ndaj të afërmeve të tij (neni 113 LFM).

Te adoptimi i plotë, të drejtat trashëgimore të adoptuarit dhe të pasardhësve të tij ndaj adoptuesit dhe familjes së tij si dhe të adoptuesit dhe familjes së tij ndaj fëmijës së adoptuar dhe të pasardhësve të tij, janë të njëjta me të drejta trashëgimore në mes të afërmeve të gjinisë së gjakut (neni 114 LFM).

Ndërsa te adoptimi jo i plotë, i adoptuari ruan të drejta trashëgimore ndaj prindërve biologjikë dhe ndaj fëmijëve të tij së gjinisë së gjakut. Kështu sipas nenit 115 par.1 dhe 2 i LFM-së, me adoptim jo të plotë në mes të adoptuesve dhe të adoptuarit, lindin vetëm marrëdhënie në mes prindërve dhe fëmijëve. Të drejtat trashëgimore midis adoptuesit dhe të adoptuarit dhe pasardhësit e tij gjatë adoptimit jo të plotë janë reciproke. Kjo vërteton faktin se i adoptuari edhe adoptuesi mund të trashëgojnë njëri-tjetrin në mënyrë reciproke, por me kusht që “kur adoptuesi në momentin e adoptimit nuk ka fëmijë të tij biologjikë” (neni 115 LFM).

Pra, nëse adoptuesit kanë fëmijë të tyre biologjikë, të adoptuarit mund t’i kufizohen të drejtat trashëgimore ose të përjashtohet si trashëgimtar i masës trashëgimore të adoptuesit.

### **3.1.9. Ndalimet për adoptim**

Sipas nenit 177 të Ligjit për Familje të Kosovës nuk mund të adoptohet personi në gjini në vijën e drejtë, as vëllai dhe motra. Gjithashtu kujdestari nuk mund të adoptojë të kujdesurin e vet, përderisa organi kompetent të mos e shkarkoj nga detyra e kujdestarisë.

Ndërsa sa i përket adoptuesit, atëherë nuk mund të adoptojnë personat e poshtëshënuar:

1. Personi të cilit me vendim gjyqësor i është hequr kujdesi prindëror;
2. Personi për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se do t’i keqpërdorë të drejtat e adoptuesit që rezultojnë në të keq të të adoptuarit ose që kërkon adoptimin për përfitime materiale;
3. Personi që lëngon nga ndonjë sëmundje psiqike të diagnostifikuar ose ka ngecur në pikëpamje psiqike, si dhe

4. Personi që lëngon nga sëmundja e cila mund ta vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e të adoptuarit (178, par.1-3 të Ligjit për Familjen i Kosovës, Nr.2004/32).

Për dallim nga Kosova, në Shqipëri nuk mund të birësojë edhe personi i cili: nuk ka garancinë si person, se duhet të kryhej në rregull detyrën e birësuesit në lidhje me mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e atij që do të birësohet, (neni 245 i Kodit të Familjes të Shqipërisë, Nr. 9062,2003).

Në Maqedoni nuk mund të adoptohet personi në vijë të drejtë, as vëllai e as motra, (neni 101 i LFM). Po ashtu sipas nenit 102 të Ligjit të Familjes të Maqedonisë, përveç dokumenteve të ngjashme me ato që kërkohen sipas legjislacionit të Kosovës dhe Shqipërisë nuk mund të jetë adoptues edhe personi:

- I cili është dënuar për vepër penale me burgim efektiv më gjatë se gjashtë muaj;
- Aftësia e tij / saj e biznesit është kufizuar ose e dëmtuar;
- Paaftësia fizike e të cilit është e një shkalle të tij që në mënyrë të arsyeshme detyrohet në mundësinë e kujdesit ndaj fëmijës;
- Që është më i vjetër se 45 vjet;
- Që është i varur nga droga ose substanca të tjera psikotrope ose alkool; si dhe
- Për të cilin mendimi i ekipit të ekspertëve të QPS-së është negative, sa i përket mundësisë që ai person të jetë adoptues.

### **3.1.10. Njohja e të adoptuarit me prindërit biologjikë dhe ruajtja e konfidencialitetit**

Ruajtja e konfidencialitetit të informative për adoptim, është e rregulluar me Konventa ndërkombëtare, po ashtu me legjislacionin e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Kështu në Kosovë Qendra për Punë Sociale, Kompetente për fëmijë, është e obliguar që të ruaj konfidencialitetin dhe privatësinë e fëmijës gjatë tërë procesit të adoptimit dhe pas adoptimit, dhe në asnjë rrethanë nuk duhet të ofrojë dokumentacionin ose informacionin nga dosja e fëmijës, përjashtimisht personave zyrtarë kompetentë. Për mbrojtën e të dhënave dhe privatësinë e informacioneve të mbledhura gjatë procesit të adoptimit, janë përgjegjëse Gjykata ku është bërë themelimi i adoptimit dhe Organi i Kujdestarisë kompetente për mbrojtjen e fëmijës. I adoptuari që arrin moshën madhore ka të drejtë në qasje në të gjitha informatat lidhur me adoptimin e tij

dhe me kërkesë të tij do t'i ofrohen informata personale për prindërit e tij biologjikë (neni 17 par.3 dhe neni 18 par.1-2 i U.A për adoptim Nr. 09/2014).

Në Shqipëri punonjësit publikë dhe privatë për shkak të detyrës kanë informacione për birësimin kanë për detyrë ta ruajnë sekretin për të dhënat që kanë të bëjnë me fëmijën, prindërit biologjikë dhe birësuesit (edhe pas përfundimit të detyrës).<sup>80</sup> I mituri prindërit biologjikë dhe birësuesit kanë të drejtën e mirëbesimit për procesin dhe dokumentacionin e birësimit, si shprehje të respektimit të jetës private. Kur mosha dhe niveli i pjekurisë e lejojnë i mituri ka të drejtë të njihet me historinë e tij dhe nëse është e mundur me të dhënat për prindërit biologjikë.<sup>81</sup> Po ashtu, Agjencitë ndërmjetësuëse vendase, detyrohen të zbatojnë të gjitha kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat për birësuesin dhe të birësuarin pasi ka arritur moshën madhore, lidhur me historinë e tij mund të kufizohen ose refuzohen, në raste të veçanta, kur ka arsye se prej tij vijnë pasojat të rënda.<sup>82</sup>

Ligji për familjen i Maqedonisë nuk e shtjellon në detaje të drejtët për ruajtjen e të dhënave të procesit të adoptimit, megjithatë, në nenin 123-a të këtij ligji, thuhet “Të dhënat mbi birësimet e vërtetuara janë një sekret zyrtar.”

Ndërsa Konventa Evropiane për Adoptim parasheh që “Fëmija i Adoptuar do të ketë qasje në informacionin e ruajtur nga autoritetet kompetente në lidhje me origjinën e saj/tij. Në rast se prindërit e tij/saj të origjinës kanë të drejtën ligjore që të mos e zbulojnë identitetin e tyre, do të mbetet në dorën e autoriteteve kompetente, për aq sa e lejon ligji, që të përcaktojnë nëse do ta anulojnë atë të drejtë dhe të zbulojnë informacionin Identifikues duke pasur parasysh rrethanat dhe duke marrë parasysh të drejtat përkatëse të fëmijës dhe prindërve të tij/saj të origjinës. Fëmijës së adoptuar që nuk ka arritur moshën madhore, mund t'i jepet udhëzimi i përshtatshëm”.<sup>83</sup>

Gjithashtu, Konventa mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimet jashtë vendit (Konventa e Hagës), në nenin 30 par.1-2 parasheh “Autoritetet Kompetente të një Shteti

---

<sup>80</sup> Arta Mandro, E Drejta Familjare, Tiranë, 2009, f.490

<sup>81</sup> Neni 262 i Kodit të Familjes të Shqipërisë, Supra note 23.

<sup>82</sup> Neni 36-37 i Ligjit për procedurat e birësimit dhe komitetit shqiptare të birësimit nr. 9695, 19.03.2007, (ndryshuar me ligjin 10 358, dt.16.12.2010, dhe 132/2015.dt 05.12.2015). Supra note 24.

<sup>83</sup> Neni 22 par.3 i Konventës Evropiane për adoptimin e fëmijëve – e rishikuar (European Convention on the Adoption of the Children – Revised), 27.XI.2008, e disponueshme në: <https://rm.coe.int/1680084823>



Kontraktues sigurojnë që të mos jepet informacioni i mbajtur prej tyre në lidhje me origjinën e fëmijës, veçanërisht informacioni me identitetin e prindërve të tij si dhe mbi historikun shëndetësor. Ata sigurojnë që fëmija apo përfaqësuesi të njihet me këtë informacion, nën kujdesin e duhur, në rast se këtë e lejon ligji i atij Shteti”.

## KAPITULLI IV

### 4. Efektet juridike dhe shuarja e adoptimit

#### 4.1. Efektet juridike të adoptimit

Me adoptim krijohen marrëdhënie të ngjashme sikur marrëdhëniet prind-fëmijë, prandaj themelimi i adoptimit ka rëndësi të veçantë. Për këtë, gjatë themelimit të adoptimit duhet të ketë parasysh gjetja e prindërve të përshtatshëm të cilët do të kujdesen për interesimin më të lartë të fëmijës.<sup>84</sup> Me themelimin e adoptimit lindin edhe efektet juridike, qoftë në mbiemër, në trashëgimi, në marrëdhënie familjare, shtetësi etj. Efekte të tilla të adoptimit ekzistojnë në legjislacionin e Kosovës, Shqipërisë edhe Maqedonisë.

Sipas nenit 190 Ligjit për Familje të Kosovës, me adoptim krijohen raporte në mes adoptuesit dhe të adoptuarit sikurse raporte prindërore. Kështu nëse fëmija adoptohet nga të dy bashkëshortët ose njëri bashkëshort e adopton fëmijën e bashkëshortit tjetër, fëmija e fiton statusin ligjor të fëmijës së përbashkët. Ndërsa nëse fëmija adoptohet vetëm nga një bashkëshort atëherë fëmija e fiton statusin ligjor të fëmijës së prindit që e adopton.

Përveç kësaj me adoptim themelohet edhe gjinia e adoptimit e cila barazohet me gjininë e gjakut. Adoptimi është bazë për dhënien e alimentacionit (ushqimit). Adoptimit ka efekte juridike edhe në emrin dhe mbiemrin e fëmijës, kështu që gjykata mund gjatë shqiptimit të adoptimit të ndryshojë emrin e parë të fëmijës ose të shtojë një apo më shumë emra të parë, nëse kjo është në interes të mirërritjes së fëmijës. Ndërsa sa i përket mbiemrit, fëmija e merr mbiemrin e prindit adoptues sikurse të ishte mbiemri i tij. Familja e re, me pëlqimin e fëmijës vendos t'i japë mbiemrin e ri para ose pas mbiemrit të mëparshëm, nëse kjo është në interes të mirërritjes së fëmijës (neni 193 i LFK-së).

Legjislacioni i Shqipërisë, parasheh efektet e birësimit në mbiemër, në trashëgimi, në dhënie familjare etj. Efektet e birësimit fillojnë kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë. Kur birësimi është i parevokueshëm (neni 258 i LFSH).

---

<sup>84</sup> Abdullah Aliu, Haxhi Gashi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007, f.256

Birësimit përgjegjësinë prindërore e ushtrojnë vetëm prindërit birësues. Pra, çdo lidhje me prindërit biologjikë ndërpritet. Amësia dhe Atësia e fëmijës së birësuar ndryshon pasi si nënë dhe babë i tij regjistrohen birësuesit. Në lidhje me përcaktimin e mbiemrit të të birësuarit vlejné parashikime që përdoren për përcaktimin e mbiemrit të fëmijëve natyrore.<sup>85</sup> Kur njëri nga të birësuarit është bashkëshort i birësuesit, i birësuarit nuk i shkëput lidhjet me këtë dhe gjininë e tij (neni 259 LFSH).

Dallim nga Kosova, në Shqipëri parashihet edhe birësimi surrogativ.<sup>86</sup> Efektet për birësim surrogativ janë të dhëna në nenin 261 të LFSH, sipas të cilit “për birësim surrogativ, të shikuar në ligjin nr. 8876, datë 4.4.2002. “Për shëndetin riprodhues”, zbatohen të njëjtat ligje dhe procedura për birësimin, sipas këtij kodi dhe legjislacioni përkatës”.<sup>87</sup> Më poshtë janë të paraqitura efektet e adoptimit në Maqedoni për rastet kur kemi adoptim të plotë dhe jo të plotë të fëmijës. Edhe këtu kemi efekte juridike për gjininë, të drejtën trashëgimore, emrin dhe mbiemrin e të adoptuarit, dhe shtetësinë e të adoptuarit. Adoptimi i plotë ka efekte juridike më të gjera, kështu që barazohet me gjininë e gjakut dhe sigurojnë të gjitha të drejtat dhe detyrat që ekzistojnë midis prindërve dhe kushërinjve të “prindërve”, (neni 113 i LFM). Adoptimi i plotë është pengesë martesore midis të afërmve, sikurse gjinia e gjakut, dhe atë në vijë të drejtë deri në pa kufi, dhe në vijë të tërthortë deri në shkallë 4 të gjakut. Te adoptimi jo i plotë nuk ndikon në humbjen e të drejtave dhe detyrimeve ndaj prindërve biologjikë dhe të afërmve të gjinisë së gjakut (neni 115 i LFM).

Sa i përket efekteve juridike për emrin dhe mbiemrin e fëmijës, në Maqedoni kjo çështje rregullohet dhe me ligjin për emrin personal,<sup>88</sup> ku sipas nenit 4 të këtij ligji “prindërit adoptues ia përcaktojnë emrin personal fëmijës së adoptuar. Nëse fëmija i adoptuar ka në emër personal,

---

<sup>85</sup> Arta Mandro-Balili, Vjollca Mecaj, Tefta Zaka, Ariana Fullani, E Drejta Familjare, Tiranë, 2006, f.655

<sup>86</sup> Me fekondim artificial kuptohet fertilizimi në rrugë eksperimentale i vezëve me spermën e mashkullit të një çifti të organizmit të gruas. Pjesëmarrja në të kushtëzohet nga pëlqimi me shkrim i gruas e cila dhuron vezët dhe mashkulli dhuron spermë”. Ligji për shëndetin riprodhues, nr. 8876,04.04.2002 (ndryshuar me ligjin nr. 10 137, viti 2009) i disponueshëm në: [https://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2002/PDF-2002/15-2002.pdf](https://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2002/PDF-2002/15-2002.pdf)

<sup>87</sup> Domosdoshmëria e vendosjes së birësimit surrogativ në KFSH, vjen nga përmbajtja e ligjit për shëndetin riprodhues, nr. 8876,4.4.2002, birësimi surrogativ mund të kërkohet pas një inseminimi artificial në rastet kur fëmija nuk është i lidhur gjenetikisht me prindërit porositës dhe as me nënën mbajtëse. Në këtë rast lindja e fëmijës bëhet me materialet gjenetike të dhuruesve anonim të vendosur nëpërmjet inseminimit në një nënë mbajtëse, e realizon dhe lindje e fëmijës. Në këtë rast çifti porositës duhet të ndjekë procedurën e birësimit për të njohur prindërit fëmijën e lindur në këtë mënyrë. Legjislacioni në fuqi i Shqipërisë nuk parashihet nën të veçante për këtë.

<sup>88</sup> Ligji për emrin personal, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë (GZRM), nr.08/95,15.02.1995, i ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për emrin personal nr. 08-1738/1,GZRM nr. 55, 22.03.2016, i disponueshëm në: <https://www.uvmk.gov.mk/sq/korniza-ligjore>

prindërit adoptues mund që gjatë themelimit të adoptimit të përcaktojnë mbiemrin e tyre ose ndonjë mbiemër të tyre, vetëm në rastet kur me anë të ankthit për themelimin e adoptimit nuk është i përcaktuar që i adoptuari të mbajë mbiemrin e tij të mëparshëm ose që mbiemrit të tij t’ia shtojë mbiemrin e adoptuesve”. Ndërsa sipas nenit 5.2 të këtij ligji, adoptuesit deri në moshën 10 vjeçare mund t’ia ndryshojnë mbiemrin fëmijës së adoptuar, ndërsa mbi moshën 10 vjeçare kërkohet dhe pëlqimi deklarativ etj.

Me themelimin e adoptimit, efektet krijohen edhe sa i përket fitimit dhe humbjes të shtetësisë.

Sipas neni 3 të ligjit për shtetësinë (LSH) 90, shtetësinë me prejardhje e fiton edhe i fiton edhe i adoptuari i cili në këtë status e ka fituar adoptim të plotë, nëse të dy ose njëri prind është shtetas i Maqedonisë, (neni 4.2 LSH). Adoptimi ka efekt juridik edhe në pushimin e shtetësisë. Kështu në Maqedoni, përveç tjerash, shtetësia pushon edhe lejim lënie edhe sipas trakteve ndërkombëtare. Me lejim lënie pushon shtetësia e të adoptuarit i cili nuk ka arritur moshën madhore, me kërkesë dhe pëlqim të adoptuesve, (neni 22 i LSH-së). Mbi moshën 15 vjeçare për pushim të shtetësisë kërkohet dhe pëlqimi i të adoptuarit (neni 22 par.4.5 i LSH-së).

## **4.2. Shuarja e adoptimit**

Ligjit për Familje i Kosovës, nga neni 196 deri 200 e trajton çështjen e shuarjes së adoptimit “ex office”, anulimin e adoptimit, si dhe pasojat e shuarjes së adoptimit. Gjykata mund të shuajë adoptimin “ex office gjatë moshës së miturisë së fëmijës, nëse për çfarëdo arsye kjo bëhet e nevojshme” për mirëqenien e fëmijës”, (neni 198 i LFK-së). Po ashtu “marrëdhënia e adoptimit mes fëmijës dhe vetëm njërit nga bashkëshortët mund të shuhet”, nëse bashkëshorti tjetër ose prindi biologjik është i pajtimit të marrë përsipër kujdesin dhe rritjen e fëmijës dhe nëse ushtrimi i kujdesit prindëror nga ai nuk do të ishte në kundërshtim me mirëqenien e fëmijës, si dhe në rast se “shuarja do të lejonte adoptim të ri të familjes”.

Neni 197 i LFK-së parasheh që “marrëdhënia e adoptimit nuk mund të shuhet, nëse mirëqenia e fëmijës do të dëmtohej qenësisht, përveç nëse interesat predominante të adoptuesit e kërkojnë shuarjen”. Kjo do të thotë se ligjvënësi ka pasur parasysh tezën se adoptimi është i shkëputshim, madje edhe në rastin konkret kur u jep interesave të adoptuesit, kundrejt interesave të të

adoptuarit, sa i përket shuarjes së adoptimit.<sup>89</sup> Sipas këtij paragrafi, interesi, më i lartë i fëmijës nuk merret parasysh, në raporte me interesat predominante të adoptuesit.

Sikurse shuarja, dhe anulimi i adoptimit mund të bëhet nga Gjykata, në bazë të kërkesës, nëse kjo ka qenë e themeluar pa kërkesë të adoptuesit, pa pëlqimin e fëmijës, prindit, për arsytet e paraqitura në pikat e paragrafit 2 të nenit 196 të LFK-së.<sup>90</sup>

Kështu të drejtat dhe detyrat në mes fëmijës dhe pasardhësve të tij me kushërinjtë e mëparshëm bazuar në adoptim ndërpriten, ndërsa të drejtat dhe detyrat mes fëmijës dhe pasardhësve të tij dhe kushërinjtë natyralë (biologjikë) së bashku me të ripërtërihen, (neni 199 i LFK-së). Shuarja ka efekt edhe në mbiemër, kështu që fëmija nuk mund të bartë mbiemrin e adoptuesit, përveç nëse Gjykata Kompetente me kërkesë të fëmijës, vendos që fëmija të mbajë mbiemrin që e ka fituar përmes adoptimit, nëse fëmija ka interesat e arsyetuar që të bart këtë mbiemër (neni 200 i LKF).

Në Shqipëri, birësimi është i parevokueshëm. Në nenin 28, të Ligjit për procedurat e birësimit (2007, ndryshuar me ligjin 10358/2010), përveç tjerash thuhet se në birësimin ndërvendas, veç dokumenteve të tjera të parashikuara për birësim ndërkombëtar, Komiteti i dërgon gjykatës edhe “vërtetimin se në vendin e aplikantëve fëmija do të gëzojë të njëjtat të drejta si në Shqipëri dhe se birësimi është i parevokueshëm”. Në Maqedoni shuarja e adoptimit rregullohet me nenet 116-123 të LFM, kështu sipas neni 116 i LFM “Adoptimi i plotë nuk mund të shuhet”. Adoptimi jo i plotë mund të shuhet pas një marrëveshjeje në mes adoptuesit dhe të adoptuarit dhe nëse komisioni vlerëson se është në interesin më të lartë për të adoptuarit (neni 117-118 i LFM).

Shuarja e adoptimit ka efekt vetëm për në të ardhmen (ex nunc), dhe nuk ka efekt retroaktiv të shuarjes së adoptimit. Vlen të theksohet se me shuarjen e adoptimit jo të plotë (sipas ligjit për familjen të RM, adoptuesi është i obliguar që materialisht të kujdeset për të adoptuarin deri në moshën madhore, duke marrë parasysh gjendjen pasurore të tyre (neni 121 LFM). Po ashtu përsëri lindin të drejta dhe detyra reciproke ndërmjet të adoptuarit dhe ish-familjes se tij, kështu i

---

<sup>89</sup> Hamdi Podgorica, E Drejta familjare, Prishtinë, 2011, f.206

<sup>90</sup> “Anulimi i Adoptimit – Kërkesa të cilës i mungon pëlqimi i nevojshëm është e pavlefshme vetëm nëse deklaruesi: 1. Në kohën e deklarimit ka qenë në gjendje të pavetëdijshme ose të çmendurisë së përkohshme, nëse kërkuksi ka qenë juridikisht jo kompetent për të kryer punë juridike, ose nëse fëmija më i ri se 14 vjet ose i paafitë për të vepruar e ka dhënë personalisht pëlqimin e tij dhe të vendimit të bërë për këtë arsye; 2. Ka dështuar të kuptojë procedurat e adoptimit ose edhe pse ai ka qenë në dijeni për këtë, nuk ka pasur për qëllim të kërkojë adoptim ose të shprehë pëlqimin e tij për procedurat e adoptimit; 3. Ka bërë gabim lidhur me identitetin e fëmijës ose fëmija që adoptohet ka bërë gabim lidhur me identitetin e adoptuesit; 4. Është shtyrë të bëjë deklaratë në mashtrim lidhur me rrethanat materiale; 5. Padrejtësisht me kërcenim është shtyrë të bëjë deklaratë”. Ligji për Familjen i Kosovës. Supra note 2.

adoptuari merr mbiemrin e tij të mëparshëm dhe me kërkesën e tij mund të mbajë mbiemrin që ka marrë gjatë adoptimit (neni 122 LFM).

### 4.3. Statistika mbi adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve

Sa i përket adoptimeve në nivel ndërkombëtar, e po ashtu edhe të shteteve të cilat kanë qenë pjesë e këtij hulumtimi (Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni), atëherë në këtë pjesë kemi paraqitur disa të dhëna statistikore për adoptimet në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe vendor.

Në vijim është paraqitur numri total i adoptimeve në nivel ndërkombëtar, për periudhën prej 1999-2017, ku shihet se janë 271.831 fëmijë të adoptuar ndërkombëtarisht, dhe prej tyre 61,1 % janë të gjinisë femërore, ndërsa 38,9 % të gjinisë mashkullore.<sup>91</sup>

**Tabela 1: Numri total i fëmijëve të adoptuar ndërkombëtarisht 1999-2017**

Në këtë numër nuk janë të dhënat e disa shteteve, si: SHBA, Suedia, Angola, Emiratet e Bashkuara, Kuvajti, Kore Veriore, Grenlanda, etj.<sup>92</sup>

Sa i përket numrit të adoptimeve ndërkombëtare në Kosovë dhe jashtë saj, atëherë numri i adoptimeve brenda Kosovës është dukshëm më i lartë në krahasim me numrin e adoptimeve jashtë Kosovës. Adoptime ndërkombëtare nga Kosova kryesisht janë bërë për fëmijët me

---

<sup>91</sup> [https://travel.state.gov/content/travel/en/Intercountry-Adoption/adopt\\_rev/adoption-statistics.html,marre](https://travel.state.gov/content/travel/en/Intercountry-Adoption/adopt_rev/adoption-statistics.html,marre) më datë 09 korrik 2018

<sup>92</sup> [https://travel.state.gov/content/travel/en/Intercountry-Adoption/adopt\\_rev/adoption-statistics.html,marre](https://travel.state.gov/content/travel/en/Intercountry-Adoption/adopt_rev/adoption-statistics.html,marre) më datë 09 korrik 2018

probleme shëndetësore, të cilët nuk kanë arritur të adoptohen në Kosovë, pasi numri i kërkesave për adoptim brenda vendit është dukshëm më i lartë se numri i fëmijëve potencialë për adoptim. Te kërkesat për adoptim ndërkombëtar të fëmijëve të Kosovës, kryesisht nuk kanë preferencë sa i përket gjinisë së fëmijës, përderisa për adoptime vendore, kërkesat më të mëdha vijnë për gjininë mashkullore. Për momentin janë nëntë fëmijë potencialë për adoptim ndërkombëtar, dy (2) nga të cilët këtë vit (2018) mbushin 18 vjet, përderisa janë 15 familje potenciale për adoptim ndërkombëtar (nga rreth 110 familje potenciale për adoptim vendor dhe ndërkombëtar). Në tabelën më poshtë janë të dhënat ndër vite (2004-2017) të numrit të fëmijëve të adoptuar jashtë Kosovës (kryesisht në Gjermani dhe Itali).<sup>93</sup>

**Tabela 2: Numri i fëmijëve të adoptuar nga Kosova jashtë saj për vitet 2004-2017**

Siç shihet nga tabela e mësipërme prej vitit 2004-2017 janë realizuar gjithsejtë 42 adoptime ndërkombëtare të fëmijëve, (në vitin 2004-4, 2005-7, 2006-0, 2007-0, 2008-1, 2009-2, 2010-3, 2011-2, 2012-3, 2013-3, 2014-1, 2015-4, 2016-10, 2017-2).<sup>94</sup>

Fatkeqësisht nuk kemi të dhënat mbi moshën, gjininë, etj. të fëmijëve të adoptuar jashtë vendit, pasi persona që merren me këtë çështje nuk kanë një sistem të mirëfilltë për ofrimin e të dhënave. Në Shqipëri, krahasuar me Kosovën numri i fëmijëve të birësuar jashtë vendit pa probleme shëndetësore është mjaft i lartë (19), dhe po ashtu nuk mungon as numri i fëmijëve të birësuar jashtë vendit me probleme shëndetësore (7).

---

<sup>93</sup> Intervistë 2018 me zyrtarë në DPSF, MPMS e Kosovës, 16 korrik 2018, Supra note 12.

<sup>94</sup> Intervistë 2018 me zyrtarë në DPSF, MPMS e Kosovës, 16 korrik 2018, Supra note 12.

Nga të dhënat statistikore (viti 2015) lidhur me gjininë e të birësuarve nga gjithsej 26 fëmijë, sa janë birësuar jashtë vendit 14 janë femra, ndërsa 12 meshkuj.<sup>95</sup> Mosha mesatare e adoptuesit ka qenë për femra 42,4 vjeç, ndërsa për meshkuj 43,4 vjet, dhe shkollimi i tyre kryesisht i lartë.

Kohëzgjatja mesatare që nga moment kur fëmija është shpallur “I braktisur” deri në momentin e birësimit është 7.4 muaj.

Shtetet në të cilat janë bërë birësime të fëmijëve të Shqipërisë jashtë vendit, për vitin 2015 janë: Itali 9, Shtete të Bashkuara të Amerikës 7, Francë 5, Kanada 4, dhe Maltë një fëmijë i birësuar nga Shqipëria.<sup>96</sup>

**Tabela 3: Numri i fëmijëve të adoptuar brenda dhe jashtë Shqipërisë për vitin 2015**

Viti	Kërkesa për birësim me pëlqim	Kërkesa për birësim vendas	Kërkesa për birësim ndërvendas	Birësime të realizuara me pëlqim	Birësime të realizuara nga institucioni	Birësime të realizuara nga Agjencitë Ndërmjetësuese	Kërkesa në total	Birësime në total
2015	5	41	23	6	22	26	69	54

Vlen të ceket se përkundër disa shkresave dhe thirrjet telefonike, drejtuar komitetit shqiptar të birësimeve të Shqipërisë (në e-mail adresa dhe numrat e paraqitur në ueb faqe të tyre ([http://kshb.gov.al/?page\\_id=49](http://kshb.gov.al/?page_id=49)), qasja ka qenë e pamundur.

Në Maqedoni, sipas të dhënave të dërguara nga përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale, janë realizuar gjithsejtë 11 adoptime ndërkombëtare të fëmijëve për vitet: 2012-1, 2013-2, 2014-0, 2015-1, 2016-4, dhe 2017-3.

<sup>95</sup> Statistika, janar-dhjetor 2015, komiteti shqiptar i birësimeve, (datë 16 korrik 2018)

<sup>96</sup> Ibid.



#### Tabela 4: Numri i fëmijëve të adoptuar nga Maqedonia jashtë saj për vitet 2012-2017

Nisur nga të dhënat e vitit 2008, kur në RM me konkretisht në Shkup kishte mbi një mijë (1000) fëmijë të cilët fëmijërinë e tyre e kalonin në rrugë, nën qiellin e hapur dhe pa përkujdesje prindërore, e ky numër në të gjithë RM arrinte afër dy mijë (2000), atëherë numri i adoptimeve ndërkombëtare konsiderohet i ulët.<sup>97</sup> Për dallim nga Shqipëria, ku kohëzgjatja mesatare e adoptimit, që nga koha kur fëmija shpallet “I braktisur” e deri në adoptim që është 7,4 muaj, në Maqedoni për adoptimin e një fëmijë pritet 3-4 vite, mirëpo ka raste të tilla që adoptuesit potencialë presin edhe 8 vite.<sup>98</sup>

Situatë shqetësuese mbetet edhe sot në Maqedoni sa i përket adoptimit të fëmijëve. Kështu që adoptimi i fëmijëve në Maqedoni mbetet akoma një temë jo aq e folur në shoqëri, dhe mund të thuhet që akoma është “tabu” temë. Fenomeni i tregut të zi të adoptimit të fëmijëve akoma ekziston në Maqedoni. Tregu i zi i adoptimeve dhe çmimet për një fëmijë të shëndetshëm dhe të bukur variojnë nga 2 mijë deri në 60 mijë Euro.<sup>99</sup>

---

<sup>97</sup> Arta Selmani, “Adoptimi në Legjislacionin pozitiv të Republikës së Maqedonisë dhe në të drejtat krahasuese të disa shteteve të rajonit”, Universiteti i EJK, Tetovë, 2011, f.138

<sup>98</sup> Ibid. f.144

<sup>99</sup> Tekstin e plotë mund ta lexoni në: <http://www.zhurnal.mk/content/?id=18689482259> (marrë më datë 03 shtator 2018)

## Përfundime

Adoptimi (birësimi) është institucion i lashtë juridik dhe shoqëror.<sup>100</sup> Nuk ka dyshim se adoptimi përveç se i ofron përkujdesje prindërore fëmijëve të braktisur, ka rëndësi dhe për adoptuesit, kështu me adoptim ata plotësojnë dëshirat e tyre për të qenë prindër dhe për të pasur fëmijë. Pengesat e tyre për të mos pasur fëmijë, ata i eliminojnë me rrugë ligjore, duke adoptuar fëmijë të mitur, të lindur nga persona të tjerë, e të cilët kanë mbetur pa përkujdesje prindërore. Tani konventat ndërkombëtare dhe po ashtu ligjet vendore lejojnë adoptimin vetëm atëherë kur është në interesin më të lartë të fëmijëve. Në të kundërtën ligjvënësi në raste të caktuara ka lejuar edhe shuarjen e adoptimit, njëjtë siç lejohet edhe heqja e të drejtës prindërore për prindërit të cilët nuk shprehin interesin e domosdoshëm për fëmijët e tyre.

Pavarësisht se Maqedonia ka një kornizë ligjore mbi adoptimin (Ligji për Familjen, Udhëzimet administrative për adoptim etj.), dhe mbi bazën e të cilave realizohen adoptime në vazhdimësi, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, megjithatë përpilimi i një ligji të veçantë “lex specials” për adoptimin vendor dhe ndërkombëtar të fëmijëve, do të ishte më se i domosdoshëm për adoptuesit dhe njëkohësisht edhe për të adoptuarit, ku në detaje do të përshkruheshin procedurat mbi adoptimin e fëmijëve, e posaçërisht adoptimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, të cilët nuk arrijnë të adoptohen në Maqedoni.

Me udhëzime apo procedura të tjera do të duhet të parashihej edhe personi kontaktues mbi adoptimin, i cili do të duhej që brenda afateve ligjore t’u përgjigjet palëve lidhur me adoptimet vendore apo ndërkombëtare të fëmijëve, të mbajë të dhënat statistikore mbi adoptimin në detaje, mbi: numrin, gjininë, moshën, shtetin, kohëzgjatjen e adoptimit etj., deri në nivelin që lejon legjislacioni në fuqi.

Gjithashtu, Kosova do të duhej të bëjë përpjekje të aderojë në Konventën e Hagës mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimet jashtë vendit, në të cilën konventë tanimë janë palë Shqipëria dhe Maqedonia.

Konventa e Hagës, që prej 25 vjet kur është edhe në fuqi (1993-2018), është adoptuar prej 96 shtetesh, ndërsa janë 3 shtete palë nënshkruese të saj. Sipas një raporti të HCCH – Shtetet


---

<sup>100</sup> Hamdi Podgorica, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2011, f.203

kontraktuese, në raport me shtetet që nuk janë nënshkruese të kësaj Konvente, duhet të aplikojnë sa më shumë që të jenë të mundur standardet dhe garancitë e kësaj Konvente.<sup>101</sup>

Sipas raportit “25 vjet nga Mbrojtja e Fëmijëve në Adoptim Ndërkombëtar” (eng-“25 Years of Protecting Children in Intercountry Adoption”) i publikuar nga HCCH, në figurën më poshtë janë të paraqitura shtetet palë dhe shtetet nënshkruese të kësaj Konvente, deri më 29 maj 2018.

**Figura 1. Shtetet palë dhe shtetet nënshkruese të Konventës së Hagës, deri më 29.05.2018**



- Shtetet palë (98)
- Shtetet vetëm nënshkruese (3)

Siç shihet nga figura më sipër, Maqedonia është palë nënshkruese e kësaj Konvente, dhe në legjislacionin e saj parasheh që adoptimi i fëmijëve të mos jetë në kundërshtim me Konventën e Hagës.

<sup>101</sup> Të dhënat e disponueshme në: <https://assets.hcch.net/docs/ccbf557d-d5d2-436d-88d6-90cddbe78262.pdf> (fq.12)

## Rekomandime

Pas hulumtimit, analizimit dhe përpunimit të këtij punimi në lidhje me adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore, në vijim janë të paraqitura disa rekomandime, gjithnjë për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore:

- Themelimi i një Agjencie të Akredituar për adoptim të fëmijëve, e cila do të kishte rol kyç edhe në adoptimin ndërkombëtar të fëmijëve;
- Vetëdijesimi i shoqërisë, posaçërisht atyre në moshë të re, për mosbraktisje të fëmijëve;
- Motivimi i shoqërisë, ngritja e vetëdijes që të adoptojnë ose të kujdesen në çfarëdo mënyrë, e cila do të ishte në interesin më të lartë të fëmijëve pa prindër, sidomos fëmijë me nevoja të veçanta, edhe nëse kanë fëmijë të tyre biologjik.<sup>102</sup>
- Mirëmbajtja e ueb faqes së institucionit kompetent për adoptim të fëmijëve, posaçërisht adoptimit ndërkombëtar të fëmijëve, duke përfshirë: mënyrën e aplikimit, dokumentet që duhet bashkëngjitur, kohën e pritjes, procesin e para adoptimit, e deri në monitorimin e fëmijës dhe familjes e cila adopton një fëmijë të Kosovës.
- Të dhënat (numri i telefonit, e-mail adresa etj.) e personit kontaktues kompetent për adoptim vendor dhe ndërkombëtar të fëmijëve, të jenë të qasshme për publikun.

---

<sup>102</sup> Esma Redzopova & Stevo Teodosijevska, një rast për admirim, e cila ishte kujdesur/adoptuar 47 fëmijë. Njëkohësisht kishte ndërmarrë veprime për mbrojtjen e grave romë. <https://www.bbc.com> (marrë me datë 05.07.2018). Esma ishte përkujdesur shumë për komunitetin rom, duke dhuruar fonde për të punuar me fëmijët dhe femrat romë, si dhe kampanjë ndërkombëtare për edukim në emër të refugjateve rom nga Kosova, për humanitetin dhe punën e saj për komunitetin rom, ajo kishte dominuar dy herë me çmim nobel për paqe, nga Republika e Maqedonisë. Artikulli i disponueshëm në: <https://www.theguardian.com/world/2016/dec/14/esma-redzopova-obituary> (marrë me datë 05.07.2018)

## Bibliografia

### I. LIBRA:

- Abdullah Aliu, Haxhi Gashi, *E Drejta Familjare*, Prishtinë, 2007
- Arta Mandro- Balili, Vjollca Mecaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, *E Drejta Familjare*, Tiranë, 2006
- Arta Mandro, *E Drejta Familjare - familja, fëmijët, martesë, bashkëshortët*, Tiranë, 2009
- Asllan Bilalli, Bedri Bahtiri, *E drejta Romake*, Prishtinë, 2015
- Asllan Bilalli, Hajredin Kuçi, *E drejta Ndërkombëtare Private*, Prishtinë, 2012
- Hamdi Podvorica, *E drejta Familjare* (botimi IV ndryshime & plotësime), Prishtinë, 2011
- Hamdi Podvorica, *E Drejta Trashëgimore*, Prishtinë, 2010
- Ivo Puhan, *E drejta Romake*, Botimi i katërt, Prishtinë, 1980
- Ksanthipi Begeja, *E Drejta Familjare e RPS të Shqipërisë*, Tiranë, 1984
- Zejnullah Gruda, *Mbrojtja Ndërkombëtare e të drejtave të njeriut* (dokumente dhe material), Prishtinë, 2010

### II. KONVENTA, LIGJE, UDHËZIME, RREGULLORE, ARTIKUJ

- Konventa mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për adoptimet jashtë vendit/ndërshtetëror-Konventa e Hagës, 29.05.1993
- Konventa Evropiane për adoptimin e fëmijëve, e rishikuar, 27.11.2008
- Konventa mbi të drejtat e fëmijës, 20.11.1989
- Deklaratë për parimet sociale dhe ligjore, për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve, me referencë të posaçme të vendosjes nën kujdes dhe adoptim vendor dhe ndërkombëtar”, 03.12.1986
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2018 (me amendamentet I-XXIV)
- Ligji për familjen i Kosovës, Nr. 2004/32
- Kodi i familjes i Shqipërisë, Nr. 9062, 2003 (ndryshuar me ligjin 134/2015)
- Ligji për familjen i Maqedonisë (teksti i konsoliduar), Nr. 153/2014

- Ligji për trashëgiminë i Kosovës, Nr. 2004/26
- Ligji për shërbime sociale dhe familjare i Kosovës, Nr. 02/L-17, 14.10.2005, (ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/1-081, 02.03.2012)
- Ligji për procedurat e birësimit dhe komiteti shqiptar të birësimit, Nr. 9695, 19.3.2007, (ndryshuar me ligjin Nr. 10 358, datë 16.12.2010, i përditësuar)
- Ligjin për shëndetin riprodhues, Nr. 8876,04.04.2002, (ndryshuar me ligjin Nr. 10 137, datë 11.05.2009)
- Ligji për emrin personal, Nr. 08/95,15.02.1995
- Ligji për shtetësinë i Republikës së Maqedonisë, Nr. 45/04, 07.07.2014, (ndryshuar me ligjin për Nr. 08-1738/1, GZRM Nr. 55, 22.03.2016)
- Udhëzim administrativ për rregullimin e procedurave të adoptimit për fëmijët pa kujdes prindëror, Nr. 09/2014
- Udhëzim administrativ për përbërjen dhe funksionimin e panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe adoptim, Nr. 12/2012
- Rregullore për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrimit për adoptuesit e mundshëm “Gazeta Zyrtare e RM” Nr. 66, 1.10.2004
- Rregullore për mënyrën e mbajtjes së shënimeve për personat e adoptuar dhe përcaktimin e dokumenteve për adoptim, Nr. 10, 28.02.2011
- Rregullore për kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes elektronike të adoptuesve, Nr. 10-2861/3, 08.05.2012
- Lori Askeland, Adoptimi ndërkombëtar, kapitulli “Fëmijët dhe të rinjtë në adoptim, jetimoret dhe kujdesi për strehim”, Greenwood Publishing Group Inc, 2005
- Arta Selmani, Adoptimi në legjislacioni pozitiv të Republikës së Maqedonisë dhe në të drejtat krahasuese të disa shteteve të rajonit, Universiteti i EJL, Tetovë, 2011
- Arta Selmani, Çështja e adoptimit në Maqedoni- RSHSL, Konferenca 2008
- Adoptimi-mbrojtje juridike për fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore sipas legjislacionit të RM-së, RSHSL, Konferenca 2008
- “25 vjet nga Mbrojtja e Fëmijëve në Adoptim Ndërkombëtar, 1993-2018”, Hagë, 2018
- Adoptimi i Fëmijëve, Trendet dhe Politikat, Nju Jork, 2009
- Përmbledhje e akteve ndërkombëtare për drejtësinë, 06.2010

- Intervistë 2018 me zyrtarë të departamentit për politika sociale dhe familjare, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Social të Kosovës, datë 16.07.2018
- MPMS (pnn), lista e dokumentacionit të kërkuar për aplikim të prindërve potencialë adoptim ndërkombëtar të fëmijës”, marrë më datë 16 korrik 2018 nga zyrtarë të DPSF
- MPMS (pnn), Buletin Informues për Procedurat e Adoptimit Ndërkombëtar, marrë më datë 16 korrik 2018 nga zyrtarë të DPSF
- STATISTIKA, Janar-Dhjetor 2015, Komiteti shqiptar i birësimeve, 2015

### III. BURIME NGA INTERNETI

- [www.hcch.net](http://www.hcch.net)
- [www.coe.int](http://www.coe.int)
- [www.europarl.europa.eu](http://www.europarl.europa.eu)
- [www.gzk.rks-gov.net](http://www.gzk.rks-gov.net)
- [www.law.harvard.edu](http://www.law.harvard.edu)
- [www.un.org](http://www.un.org)
- [www.bbc.com](http://www.bbc.com)
- [www.theguardian.com](http://www.theguardian.com)
- [www.pravdiko.mk](http://www.pravdiko.mk)
- [www.mtps.gov.mk](http://www.mtps.gov.mk)
- [www.uvmk.gov.mk](http://www.uvmk.gov.mk)
- [www.travel.state.gov](http://www.travel.state.gov)
- [www.kshb.gov.al](http://www.kshb.gov.al)
- [www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)
- [www.ikub.al](http://www.ikub.al)
- [www.botasot.info](http://www.botasot.info)
- [www.pages.uoregon.edu](http://www.pages.uoregon.edu)
- [www.ohchr.org](http://www.ohchr.org)
- [www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org)
- [www.zhurnal.mk](http://www.zhurnal.mk)

## **Deklaratë e studentit**

Unë, Labinot Ziberi, lindur më 12 korrik 1995, në Shkup, në fshatin Llaskarcë me nr. të dosjes së ID 122111, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Evropës Juglindore të Tetovës në Programin Master E Drejta Civile, deklaroj se punimi i titulluar “Adoptimi ndërkombëtare i fëmijëve-aspektet krahasuese”, është puna ime origjinale dhe nuk është dorëzuar në tërësi apo pjesërisht, për ndonjë gradë në këtë apo ndonjë universitet tjetër. Punimi nuk përmban, (sipas njohurisë time), asnjë material të botuar ose shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç burimeve të cituara në mënyrë të rregullt, apo për të cilat është vënë shpjegim eksplicit në tekst, apo i njëjti nuk ka qenë pjesë e ndonjë punimi të shkruar nga unë apo ndonjë person tjetër.